

JANI THOMAJ

PROBLEME TË FRAZEOLGJISË SË GJUHËS SHQIPE

Objekt i këtij punimi janë ata togfjalësha të qëndrueshëm të formuar historikisht, që nga ana kuptimore janë ekuivalentë me një fjalë të vetme dhe, sikurse fjala, shprehin nocione, dmth. karakterizohen nga funksioni emërtonjës. Këta togfjalësha përbëjnë frazeologjinë e gjuhës.

Në një punim të vetëm si ky nuk mund të jepen në mënyrë të plotë dhe përfundimtare veçoritë e ekuivalentëve të fjalëve në gjuhën shqipe. Frazeologjia është një fushë e gjerë studimi. Këtu duam të shtrojmë disa probleme që meritojnë vemendje në studimet tona të ardhme dhe zgjidhja e të cilave merr një rëndësi praktike tani në prag të hartimit të fjalorit të gjuhës shqipe dhe përgjithësisht në këtë fazë të studimeve në lëmin e leksikut të shqipes. Çdo çështje e shtruar këtu përbën një objekt më vehte për një studim më të thelluar.

Materiali faktik është grumbulluar nga vepra të ndryshme të literaturës së shkruar shqipe (libri, gazeta, revista etj.) të autorëve të ndryshëm që nga "Meshari" i Buzukut dhe deri në ditët tona, nga fjalorët më kryesorë për shqipen, si dhe nga goja e popullit¹⁾ me anë të ekspeditave leksikologjike. Janë çfrytëzuar gjithashtu materialet e dy fjalorthëve, dorëshkrim pranë sektorit të leksikologjisë e leksikografisë: një fjalor frazeologjik anonim²⁾ dhe një fjalorth frazeologjik me bazë foljore i Gj. Sheldisë, të dy në gegërishten. Lënda e folklorit, — proverbat, fjalët e urta, gjëzat, botuar nga S. Kolea, K. Kamsi, S. Dine, Instituti i Folklorit, ose në "Visaret e Kombit" dhe në periodikët para e pas çlirimit si tek "Illyria", "Hylli i Dritës", "Shkolla kombëtare", "Leka", "Buletini i Shkencave Shoqërore" nën rubrikën "Fjalë e fraza të pambledhura" etj., — nuk është patur për bazë në studimin e frazeologjisë shqipe, veçse në rastet kur proverbat, fjalët e urta etj. paraqiten si të ndërmjetme, kalimtare, nga elemente të folklorit në frazeologjizma gjuhësorë, ose kur ndonjë nga gjymtyrët e tyre është në vetvehte një frazeologjizëm gjuhësor.

Sadoqë togfjalëshat frazeologjikë dokumentohen që me veprat më të para në gjuhën tonë, pasqyrimi i tyre në gramatikat e shqipes ose në studimet e veçanta është mjaft i vonë dhe i sipërfaqshëm. Duke u vlerësuar herë si njësi të sintaksës, herë si kategori leksikore dhe më shpesh si materiale të folklorit nën emërtime të ndryshme si "shprehje", "fraza", "frazeologji" etj., këta togfjalësha frazeologjikë nuk janë trajtuar gjer më sot në asnjë nga këto fusha në mënyrë sistematike, të qartë e të plotë. Mirëpo kjo gjendje e studimeve në fushën e frazeologjisë shqipe është pasqyruar

1) Për materialet e mbledhura nga gjuha e popullit, për shkurtim pune dhe për të mos kufizuar fushën e përdorimit të këtij apo atij frazeologjizmi, nuk janë dhënë ubikacionet përkatëse.

2) Mund të jetë i Kordinjanos ose i Valentinit.

konkretisht me të gjitha pasojat e saj në leksikografi, në dhënien e saj ndër fjalorët e shqipes.

Për të parën herë togfjalëshat frazeologjike formulohen teorikisht në artikullin "*Mbi thjeshtësin e gjuhës*" (1921) të Prof. Dr. Aleksandër Xhuvanit.

Nën termin "*lokucionet*" përfshihen "mënyrë të të foluni, domethënëja e të cilave ka rrjedhë jo nga fjalët që i formojnë lokucionet, por nga përdorimi i ktyne fjalëve, një përdorim si me thënë i breshnuem qi u ka dhënë ktyneve, të marrun si një grumbulli, një kuptim mbë vehte.... p. sh. *me kallzuem diçka për fije e për pe; me i ardhun një gjaje për për gëzof; me mbuluem një gjë fill'flakë; me dalun tijës; me i ardhun ndokujt tjegulla për qark; me pasun një qiell e një dhe prej ndonji gjaje; me ranë shi në grykë-të shtëmbës ase gjerbë qiejsh, etj., etj.*" Po nën këtë grup të titulluar *lokucione* përfshihen edhe "ato qi kanë një karakter proverbi; p.sh. *me kërkue; halë në përpeq; voji po në laknat bije; me ja futun kambët në një këpuçë; me i ranë murit me krye; me ja bamun dhambët misër; vera me lule, dimni me cule etj. etj.*" ("*Studime gjuhësore*", Tiranë 1956, f. 11).

Siç shihet, autori thekson këtu në radhë të parë unitetin semantik të këtyre togfjalëshave, — i përftuar nga përdorimi i shpeshtë i tyre, — si tiparin kryesor për përcaktimin si lokucione. Më poshtë përmenden shkurt edhe tipare të tjera si pamundësia e lokucioneve për t'u ndryshuar, pamundësia për t'u përkthyer fjalë për fjalë në një gjuhë tjetër (krh. fr. *il va sans dire*, që fjalë për fjalë do të thotë *vetë pa thënë* dhe përkthehet në shqip *merret vesh*); theksohet gjithashtu se "kuptimi i lokucioneve nuk qëndron te fjalët veçan, por tek e folmja e tanë".

Përkundër lokucioneve, Prof. A. Xhuvani ve frazat "të cilat janë mënyrë të folunit që e kanë marrë kuptimin jo prej përdorimit, por prej fjalëve veçan, p. sh. *me i dalun zot; me e nxjerrë mbë krye a me e qitun mb'anë një punë, me i vumun mend a vesh një gjaje; me qënë i zoti i vetiut; me bâmun e me vumun buzën mbë gaz; me i vramun vetullat; me i rrudhë hundët, me i ardhun shpirti në fytyrë a në majë të hundës, etj. etj.*

Në fillim lokucionet kanë qenë frazë, por mbasandaj prej përdorimit të shumtë që i u është bâmun u-breshnuen e muerën një veshtirim të premë". Të ndërmjetmë midis lokucioneve e frazave merren rastet si i *luejti mendja*.

Këtu kemi edhe një përpjekje për të interpretuar disa veçori të frazeologjizmave të shqipes, si dhe për një klasifikim të thjeshtë, sipas kuptimit dhe përdorimit të këtyre frazeologjizmave. Po në këtë artikull përmendet edhe çështja e mundësisë së huazimit të frazeologjizmave, me anë të përkthimit fjalë për fjalë (kalke) nga gjuhë të huaja, si fr. *faire impression* — shq. *me bâmun përshtypje* etj., si dhe karakteri arkaik i disa frazeologjizmave të shqipes, p.sh. *baj pallë* (f. 15).

Përmbi ruajtjen e pastërtisë së frazeologjisë shqipe, sidomos gjatë përkthimeve bëhet fjalë shkurtimisht në artikullin "Thërmije gjuhe" (1944) në "*Studime gjuhësore*" f. 54-55. Këtu përmenden edhe disa fraza shqipe si *ve buzën në gaz, baj buzën në gaz, shpie buzën në gaz, më vjen keq, më vjen mirë* etj.

Në artikullin "*Frazeologjia shqipe (lokucionet) në veprën e Naim Frashërit "Histori e Shqipërisë"* të Nonda Bulkës (Bul. Univ. Sht. të Tiranës, Seria Shk. Shoq., I, 206) theksohet më tepër karakteri letrar i "lokucioneve", ekspresiviteti dhe bukuria e tyre në shprehjen e mendimit dhe ndjenjave. Por këtu nuk vihet kufi nëmes elementit letrar dhe atij gjuhësor në frazeologji. Edhe në formulimin teorik kjo çështje nuk jepet qartë. Autori i artikullit i quan lokucionet *pasuri të gjuhës*, të një rëndësie me fjalët, por

më poshtë shprehet kështu: "sipas mendimit tonë ato *hyjnë në folklorin* popullor, ashtu si *hyjnë proverbat, gjëzat, fjalët e urta*. Lokucionet janë shprehje metaforike që po t'i përkthesh fjalë për fjalë në gjuhë tjetër e humbasin kuptimin e tyre. Naimi e ka njohur me rrënjë folklorin tonë". Pra, këto elemente quhen thjesht elemente të krijimtarisë artistike të popullit, elemente letrare.

Në paraqitjen e materialit konkret janë dhënë drejt mjaft frazeologjizma të gjuhës, p.sh. Sulltani *i vrit të trasha; ca muarrë arratinë*; të tjerëve *u dha datën*; posi nata *mori dhenë*; dhe na *vu në dorë mbrenë*; po *kishte duk trimëria*; ushtërisë *i dha dhenë*; të shumtët *kafshuan dhenë*; të pësoj sot këtë punë / e të më *thyhet hunda?*; nuk i la të *bënin këmbë*; veç engjëllit t'urtësisë / t'jater s'e *heth dot atë lumë*; *mblidhni mëndjen në kokë*; *kë të zësh ngoje* më parë; që s'*kish Turqit për pesë*; *dha zoti porropinë*; *më qaf* përse *i bie*; *sy e faqe më s'na mbeti* (turpërohem); gjithë armikët në fortesë e *kishin tani synë*; e vanë *me shpirt për dhëmbë*; mbreti nuk u *vuri veshnë*; e *mori vesh* djallëzinë etj.

Këta janë frazeologjizma tashmë të formuar, me kuptim unik e të përcaktuar, ekuivalent me një fjalë të vetme. Por radhazi me këto në këtë artikull merren si lokucione edhe kombinimet e lira të një fjale polisemantike me fjalë të tjera, si p. sh. pasi shkoi një *copë* ditë; se u *doq* ng'ajo q'e gjeti; pashaj me gjuhë *të trashë*; s'e *ha* dot me Skënderbenë; u *dha* mbita si shkëndijë; kur në derë u *dha* një djalë; pa një her'u *kapërxye* (gëlltiti pshtymën); u *këput* me pak shokë (iu nis); e *rëndë* nga trimëria; dhe ajo *rreh* ta gënjejë; jetën e *tuntnë*; pa u *thye* ushtëria; u *këput* e ra në truall *zëninë* si mizëria etj.¹⁾

Të këtillë konsiderohen edhe urimet e mallkimet, si: Mos e *dhëntë Perëndia*; e *gjettë nga Perëndia*; të *ndritë shpirti* për jetë; mos *qoftë thënë* kurrë, të *lumtë* goja këndona, etj.

Gjithashtu në vëllimin e frazeologjisë përfshihen edhe kompozitat: dhe asnjë s'erdh *dorë-thatë*; mos i vriste *dorë-gjati*; kishte vdekur *gjëmë madhi*; dhe e lë shkret e *lugë-thatë*; u prishnë e u shpërndanë / të tërë *sakaqherë*; Skënderbeu *zëmër-deti*, etj.

Tek teksti ynë "Leksikologjia shqipe" (dispencë 1961) frazeologjia është parë në prizmin e kërkesave mësimore, d.m.th. për të dhënë konceptin mbi frazeologjinë, kufijt e saj, dallimin nga togfjalëshat e lirë, klasifikimin dhe disa veçori të strukturës semantike dhe formale.

Tek artikulli i M. Çelikut "Togfjalësha të qëndrueshëm foljorë në shqipen e sotme" (Bul. Univ. Sht. të Tiranës, Seria Shk. Shoq., 1962, II, 194) togfjalëshat e qëndrueshëm kapen si njësi gramatikore dhe si njësi leksikore. Për studimin tonë tërheqin vemendjen "togfjalëshat e qëndrueshëm foljorë me drejtim leksikor ose të leksikalizuem plotësisht" (203). Në kapitullin përkatës të punimit të dhënë formulohet koncepti i këtyre togfjalëshave, duke përmendur si veçori dallonjëse të tyre strukturën prej dy a më shumë komponentësh (fjalë kuptimplote), unitetin e këtyre komponentëve si nga pikëpamja formale ashtu edhe semantike. Më tej bëhet klasifikimi i këtyre togfjalëshave për nga shkalla e leksikalizimit dhe nga mënyra e formimit të tyre.

Në një kapitull të veçantë të këtij punimi trajtohen "togfjalëshat foljorë të leksikalizuem të tipit frazeologjik", të cilët, si të parët, konsiderohen si njësi leksikore, por të përfutur "jo me rrugën gramatikore, por

1) Nënvizimi i fjalëve polisemantike është bërë nga ne.

kryesisht me rrugën leksiko-frazeologjike në bazë të shprehjeve figurative” (209).

Me të drejtë në këtë punim drejtohet vemendja në një lloj të veçantë të togfjalëshave të qëndrueshëm, në ata që semantikisht janë ekuivalentë (ose sinonime) me fjalë të vetme. Por karakteri i tyre gramatikor (a janë vetëm të tipit foljor?), klasifikimet e bëra sipas kriteresh së ndryshme, kufizimi sipas gjymtyrëve përbërëse, vlera e përgjithëshme e materialit faktik dialektor të përdorur, interpretimi i disa tipave (si tipi *knoj shkoll* me ”marrëdhanie vendore”, shkaku i ”përdorimit të gjymtuem” (të disa ”idiomave” etj.), kuptimi i karakterit idiomatik të togfjalëshave, rendi i problemeve të studjuara e disa çështje të tjera lidhur me frazeologjinë e gjuhës shqipe kërkojnë një studim shumë më të thellë e më të gjerë. Edhe karakteri ekuivalent i frazeologjizmave gjuhësorë me një fjalë të vetme nuk është kuptuar drejtë.

Përsa u përket gramatikave të shqipes ato nuk e kanë pasur objekt të vetin fondin e frazeologjisë së gjuhës.

Edhe ndër ato gramatika, ku janë përmendur togfjalëshat frazeologjikë, vemendja kryesisht i është kushtuar funksionit të tyre gramatikor, si krye-fjalë, kallëzues apo plotësa.

Ilija Dilo Sheperi, në ”Gramatikën dhe sindaksën e gjuhës shqipe” (Vlorë 1927, f. 139), togfjalëshat frazeologjikë i përfshin nën termin *lokusion* dhe jep këtë përkufizim: ”Quajmë lokusion dy (ose dhe tri) fjalë, të cilat ndoshe të ndara, përbëjnë të dya një kuptim të veçantë ose një formë të fjalës (të së dytës), ose një pjesë tjetër të ligjeratës. P.sh. marr vesh (=kuptoj); kam shkuar (=shkrova); në vënd (të... parafjalë). Shënim. Lokusionet quhen *emërorë, mbiemërorë, foljorë* et., kur përbëjnë emëra, mbiemëra; foljet et. P.sh. marr vesh=lokusion *foljor*; në vënd (të...)= lokusion *parafjalor* et.”

Dhe më tej: ”Nga lokusione të shpeshpërdorurë bëhen fjalë të përngjitura. P.sh. domosdo; domethënë; mbase; sikur; dymbëdhjetë; kuje; kushtrim, et.

Shumë fjalë duke u bërë të përngjitura bëhen përnjëherthi dhe të prejardhura... Kështu dhe shumë lokusione. P.sh. marr vesh, marrëveshje; zë vënd, zëvëndës; vë rë, vërej; bëj zë, bëzëj.” (f. 140). Ky mendim përsëritet edhe në f. 142, duke u vënë disa nga shembujt e mësipërm në një radhë me ”kohët e përngjitura e të dypërngjitura” të ndërtuara me foljen *kam* dhe *jam*. Edhe këto quhen lokusione, si dhe konstruktet prej nga kanë ardhur *dorëhigem, buzëqesh* e *duartrok* (f. 141). Autori quan lokusione edhe ”*ndaj mbrëma, nja pesë*” (fig. 147), ”*më vjen keq* (=ndjej mëshirë), *më vjen ligëst* (=ndjej idhërim), *më vjen mirë* (=ndjej kënaqësi)” (f. 159), konstruktet e përbërë ”prej foljes *jam* me emërat *nevojë, punë, e mira, e drejta* et., kur kanë si kryefjalë fjali të dytë. P.sh. Është *nevojë* të punojmë”, hile edhe kur ”në lokusione të këtyllë folja *jam* shumë herë nënkuptohet. P.sh. *Nevoja* të punojmë. E *mira* të mos keshe folur.” (f. 159-160). Po kështu quhen lokusione edhe ”*dua*” me pjesoren. P.sh. ara do punuar (=duhet të punohet), *dashka* rrahur (=duhet të rrahët)” (f. 182), si dhe ”me gjithëqë, sado që, sido që, edhe se, dhe në” (f. 196) etj.

I. D. Sheperi i trajton këto ”lokusione” kryesisht në kapitullin ”Përngjitja” të pjesës ”Etimologjia”. Ky fakt duhet shënuar për të kuptuar edhe konceptin aq të gjerë dhe të njëanshëm të autorit për termin ”lokusion”: prej tij është marrë për bazë ana e formimit, e prejardhjes, e ndërtimit të lokusioneve, duke lënë mënjanë tiparin semantik, tiparin gramatikor etj., njohja dhe zbatimi i të cilëve të çon në përfundime të qarta

e të drejta në grupimin e shprehjeve (në kuptimin e gjerë të kësaj fjale.). Këndi i gjerë i pamjes në rastin e dhënë ka çuar në përzjerje të frazeologjisë gjuhësore me lokucionet gramatikore (ndajfoljore, parafjalore etj.), me bashkime të lira fjalësh, me forma të përbëra gramatikore, me kompozitat (përngjitjet) etj.

Koncepte të tilla mbizotërojnë edhe në gramatika të tjera. Tek "Gramatika shqipe" e K. Cipos (Tiranë 1949) tipi *fol e qesh* (ajo nuse qenka fol e qesh) quhet *grup fjalësh* (f. 107), shembujt *bëka ftohtë, s'është e udhës, po bën vapë, u bë ditë, ka tym, ka erë* përmbliken nën emërtimin e vetëm *lokucione pavetore* (f. 107), rastet "ra i sëmurë, më zunë ethe, hypi në front, i erth goja foshnjës — zuri të flasë, bëri golën" (Variboba) — nisi të flasë", merren si "folje në aorist që tregojnë fillimin e një pune a të një mënyre së qeni", me idenë e aspektivitetit, pikërisht si aoristat inkoativë grekë" (f. 113), kurse trajtohen si *kompozita sui generis* tipi *gur kufiri, bukë gruri, ve pate, lëng pule, lule dhënsh, voj ullish, zoq pulash, lëkurë dhelpre, mulli vaji, djathë shakulli, zok pule* etj. (f. 43 dhe në "Sintaksën", 1952, f. 16, 22). Këtë rastin e fundit e përmendim se na duket që shembujt e dhënë më tepër bien erë frazeologjie se sa kompozite.

Emërtime të ndryshme jepen edhe për raste të tjera, si: *fjali të fshehta* ose *pseudofjali* për *dyqan shteti* etj. ("Sintaksa", f. 4), *fraza të vetme* për *kam uri, kam et, më dolli mënc, mba vesh, lidh miqësi, jap llogari, mbaj me fjalë; fraza ndajfoljore* për *mbë kalë, mbë këmbë, me kënaqësi, me gjithë qejf, shend e erë, më drekëherë, me të gdhirë me guxim, me djallëzi* etj. (f. 22); *folje* (si njesi të vetme) barabar për *lind, vdes, shton* dhe për *jep kuje, lëshon majë, bën ballë* (f. 36); *shprehje* për *është e udhës, s'është e udhës, është me vënd,* etj. (f. 39), *orë më orë, ditë më ditë, dy herë në ditë, javë për javë* (f. 74), *ngre në gjyq* dhe *krahas saj akuzoj, padit* (f. 79); *perifrazë për vate prishur* (Turgut Pasha), ku "të dy foljet *vate prishur*, në analizën logjike përbëjnë një folje të vetme, me që të dy bashkë ato folje mund të hyjnë në punë për të na dhënë aspektin konklusiv të veprimit" (f. 56); *lokucione* (ndajfoljore) për *shkel e shko, vesh më vesh, për fat të mirë, për fat të keq, krahas alla turka, alla frenga, mbë gjunjë, për djallë, me të shpejtë* e këto krahas *përmbys* (f. 82).

Edhe në këta shembuj mund të shihet se funksioni gramatikor i "lokucioneve", "shprehjeve" apo "frazave" ka qenë thelbi i analizës së tyre. Karakteri leksikor i tyre nuk është patur parasysh.

Justin Rrota, në "Sintaksin e Shqipes" (Shkodër, 1942), arrin të veçojë "një rend të vogël verbash frazeologjike të prurë sa për shëmbull". Nga lista që është dhënë është vështirë të përcaktosh mirë kriteret e këtij veçimi, edhe kur autori thotë vetë se "ka verba, të cilët ndër disa mënyra së thanunit me ndihmën e objektit a të advërbjarit, apin një kuptim të posaçëm, krejt të ri, shpesh tue ia largue veshtrimit të parë" (f. 42). Nga kjo dhe nga lista e shembujve nuk del qartë se vetëm komponenti foljor është frazeologjik apo gjithë mënyra e të "thanunit". Në këtë listë prej 153 shembujsh me të drejtë janë përfshirë frazeologjizma si *baj ball, baj fjalë, baj kambë, baj (e) livadh, baj pall, bajn (më) syt / veshët, bie në s., bie në gjuj, kam gisht / dorë* etj., por janë dhënë edhe konstruktë që për ne nuk janë formuar si frazeologjizma, si *dal i pabesë, del (s'më) kohë, dij për mendësh, kam (s') punë* etj. Megjithatë është me rëndësi që nga autori i sintaksit kapet veçan kjo kategori shprehjesh, edhe pse ai nuk jep asnjë trajtim teorik për to, as klasifikimin, as karakteristikat e tyre.

Janë shprehje, besojmë, të nxjerra nga ndonjë fjalor, më të ngurosurat në shqipe, të ndërtuara kryesisht me foljet *baj, bie, çoj, dal, ha, hjek, lã,*

marr, mbes, vë, xë etj. Me fort pak përjashtime përcaktimi i këtyre shprehjeve si frazeologjike është i drejtë. Siç duket, autori ka patur parasysh vetëm shprehjet më idiomatike të shqipes dhe vetëm ato foljore, — dy kufizime që çojnë në një kuptim jo të drejtë si të vetë konceptit frazeologji, ashtu edhe të vëllimit të saj. Si dhe në gramatika të tjera, autorin e ka tërhequr këtu më tepër ana gramatikore e këtyre shprehjeve, funksioni i tyre si folje.

Në "Gramatikën e gjuhës shqipe" (Pjesa e dytë. Sintaksa. Botim i tretë, Tiranë 1957) të Prof. Mahir Domit janë dalluar si njësi më vehte me funksion sintaktik të caktuar si kallëzues foljorë "shprehje" të formuara prej një folje e prej një emri të shoqëruar ose jo me parafjalë. Në këto raste ky grup fjalësh formon një kuptim të vetëm, ka vlerën e një folje dhe mund të marrë edhe kundrinë të drejtë a të zhdrejtë. Të tilla janë shprehjet: *mbaj mend, kam frikë, ngul këmbë, i zë besë, e qis në krye* (një punë), *i bëj ballë, ve vesh, ve dorë* etj. (f. 28). Funksioni sintaktik si kallëzues foljor shënohet edhe për "një shprehje të formuar prej foljes *jam* të bashkuar me ndonjë fjalë tjetër, p.sh. Ishte në mbarim e sipër korrija e grurit", si dhe për "shprehjet pavetore më *vjen keq* (që s'erdha me ty në fshat), *ra shi* (shumë dje)" (f. 28). Në faqen 156 quhen shprehje pavetore përsëri konstruktet e formuara prej foljes *jam* e një emri, mbiemri a ndajfoljeje. P.sh. *ish e pamundur, është marrëzi, është mirë*, dhe më poshtë më *vjen keq, më bie ndërmënd*. Në faqen 30 fol e qesh quhet shprehje e njëllajtë me fjalinë, kurse *hynte e dilte* ("Ai hynte e dilte atje si në shtëpi të vet"), sadoqë nuk titullohet shprehje, kjo nënkuptohet, sepse këto dy folje të bashkërenditura merren si "një kallëzues i vetëm" dhe "të lidhura ngushtë ndërmjet tyre e (që) formojnë një kuptim".

Po kështu në funksionin sintaktik të kryefjalës vihet edhe "një tog fjalësh që shënojnë një send të vetëm. Kjo ndodh më shpesh kur kemi të bëjmë me tituj dhe emra institutesh. P.sh. *Bashkimi Sovjetik...*, *Deti i Zi... Biblioteka Kombëtare...*" (f. 23); në faqen 40 *Bashkimi Sovjeti*, "Lulet e Verës", dhe në faqen 44 "Zëri i Popullit" quhen grup fjalësh.

Me termin shprehje emërtohen njësoj që sot e kësaj dite (f. 91), nga shkaku i, për shkak të, për punë të; nga puna e, për shkakun (f. 95), me anë të, me anën e, me ndihmë të a me ndihmën e, për hir të (f. 98), pas mënyrës së, në formën e, në formë të (f. 101), se për të qeshur (f. 108), bashkë me, së bashku me, në shoqëri me, në bashkëpunim me (f. 109), nga ana e, prej anës së (f. 113- shih edhe f. 122), jo vetëm (që) . . . , po (edhe); jo vetëm . . . , po as; përveç që, po edhe (f. 147). Tipi dy herë ("kam ardhur dy herë tek ti, po s'të kam gjetur") quhet shprehje ndajfoljore (f. 104), kurse dy nga dy ("Nxënësit po dilnin nga klasa dy nga dy) dhe kokë për kokë ("U dërgoi të fala të gjithëve kokë për kokë") trajtohen si "tog fjalësh që formojnë një shprehje me kuptimin të mënyrës" (f. 101). Shënojmë më në fund se rasti *luejti mendsh* (= u çmend) nuk është konsideruar si shprehje foljore, por *mendsh* është veçuar si plotës kufizimi (f. 81).

Nga gjithë ky rrjeshtim shembujsh dhe emërtime shprehjeve del se frazeologjizmat gjuhësorë janë përfshirë pjesërisht në lentën e studimit, por kjo është bërë për të shënuar kryesisht funksionin sintaktik të tyre si një gjymtyrë e vetme e fjalisë dhe shkarazi unitetin semantik të këtyre shprehjeve, duke lënë mënjandë tiparet e tjera të frazeologjizmave të gjuhës, gjë që ka shpërë përsëri në përzjerjen e frazeologjizmave të gjuhës me lokucionet gramatikore (lidhore, parafjalore etj.) në të njëjtën kategori të shprehjeve.

Edhe në tekstin e S. Priftit "Sintaksa e gjuhës shqipe" (botim i U.S.H. T., 1962) togfjalëshat frazeologjikë trajtohen në kapitullin mbi kallëzuesin

(foljor) dhe quhen *shprehje ndajfoljore* ato që përbëhen "nga një folje dhe një ndajfolje, në të cilat kuptimin kryesor e mban ndajfolja dhe jo folja, sepse në ndajfoljen përmblihet rezultati i foljes: Për këtë shkak e tërë fraza mund të kthehet në një folje të formuar nga ndajfolja. P.sh. u bënë afër (u afëruan), u bënë larg (u larguan), u bëra vonë (=u vonova), bëhuni bashkë, bëra mend etj." (dispenca I. f. 74).

Siç shihet, këtu bëhet një përpjekje për të zbuluar edhe fokusin semantik e fjalëformues të togfjalëshit.

Në një shënim më poshtë, nën emërtimin *perifraza*, që duhen marrë si kallëzues i vetëm në analizën sintaktike dhe që kanë aftësinë të kthehen në një folje të thjeshtë, përmblihen këta shembuj: *marr vesh, e marr sysh, e marr me mend; jap ndihmë* (=ndihmoj), *bëj luftë* (=luftoj), *kam shpresë* (=shpresoj); *kam ndihmë* (=ndihmohem), *s'kam të sharë, të mbaruar; marr dënimin* (=dënohem), *merr të nxehtë* (=nxehet), *thith lagështirë* (=laget) etj. (f. 75).

Në këtë mënyrë edhe këtu theksohet funksioni sintaktik i këtyre togfjalëshave, si dhe vlera e tyre kuptimore, ekuivalente me folje të thjeshta.

Vende-vende gjejmë edhe termin *grup foljesh* për konstruktet *qep e shqep* (s'mbarohet puna, f. 168), (mos punoni) *shkel e shko* (f. 169) etj.

Zgjidhja teorike e problemeve të frazeologjisë shqipe do të kishte krijuar mundësinë për leksikografët që ta pasqyronin sa më gjerë e sa më drejtë atë ndër fjalorët e ndryshëm. Megjithatë, përsa i përket vëllimit, tek fjalorët ne gjejmë një pasuri të konsiderueshme frazeologjizmesh të shqipes, sidomos pas shenjës rromb.

Nuk kemi parasysh fondin e proverbove që jepet, p.sh. tek fjalori i F. Bardhit, i A. Leotit etj., por atë pasuri frazeologjike që shërben si material ilustrues i kuptimit të fjalëve. Më të varfër me frazeologji janë fjalorët dy gjuhësh, pikërisht gjuhë e huaj - shqip. Autorët (kryesisht të huaj) kanë dhënë ndër këta fjalorë pasurinë leksikore të gjuhës së huaj të përkthyer në shqip, duke lënë mënjanë pasurinë frazeologjike; shih p.sh. për këtë fjalorin italisht - shqip të F. Rosit, të A. Buzetit, të F. Kordinjanos etj. Por është relativisht i pasur në frazeologji fjalori serbokr.-shqip i Bariçit (1950). Fjalorët shqip-gjuhë e huaj janë më të pasur në krahasim me të parët, p.sh. fjalori i shoqërisë "Bashkimi", fjalori shqip-serbokroatisht i L. Lukajt dhe ndër ata të pas çlirimit "Fjalori i gjuhës shqipe" i Inst. të Shkencave (1954).

Duke lënë mënjanë anët pozitive të fjalorëve të shqipes lidhur me pasqyrimin e frazeologjisë, që pa dyshim nuk mungojnë, këtu duam të japim disa vërejtje për të metat e tyre në këtë drejtim, të cilat përgjithësisht mund t'i formulonim kështu:

1. Frazeologjia nuk pasqyrohet në një masë të kënaqëshme, disa tipa dhe shumë frazeologjizma të zakonshëm dhe të përdorur në stile të ndryshme, bile dhe nga ata të burimit popullor, nuk përfshihen në vëllimin e frazeologjisë.

2. Nuk pasqyrohen në të njëjtën masë tipat strukturalë, fjala vjen ndërtimet me komponentin *dorë* pasqyrohen më pak se sa ata me *sy* apo *anajsjelltas*, frazeologjizmat foljorë më tepër se tipat e tjerë etj.

3. Nuk jepen spjegime të plota e të qarta, për frazeologjizmat që kanë më shumë se një kuptim; shumë nuanca kuptimore nuk shënohen os shënohen sipas kriteresh jo të drejta, nuk jepen gjithënjë variantet formale të frazeologjizmit, mungojnë kudo shënimet stilistikore, nuk vlerësohet dhe nuk vihet në dukje nuanca emocionale e frazeologjizmit.

4. Në shumicën e rasteve nuk i jepet frazeologjisë një vend i pavarur

në fjalor, pas shënjes përkatëse. Kuptimet e lidhura frazeologjike nxirren si kuptime të pavarura të fjalës titull dhe frazeologjizmat jepen si ilustrime të tyre nën shifrën përkatëse.

5. Tipat e frazeologjizmave (idiomat, njësitë, bashkimet) jepen të përzierë dhe jo sipas një radhe të caktuar, nuk dallohen.

6. Frazeologjia përziejehet me bashkimet e lira të fjalëve, me raste të polisemisë, me proverba, sentenca etj.

7. Në të gjithë fjalorët nuk jepen shënime për sferat e përdorimit të frazeologjizmit, për kufizimet leksiko-gramatikore të tij, në rast se ka (ngurosja, rendi i fjalëve etj).

8) Shpesh herë merren si frazeologjizma mënyra të përdorimit të një fjale në një kombinim të lirë fjalësh, ku ajo mban po atë kuptim që e ka themelor si fjalë titull.

Për ilustrim po marrim vetëm një shembull: pasqyrimi i frazeologjisë së ndërtuar me fjalën *marr*, ndër disa fjalorë të shqipes.

F. Rosi¹⁾ në vendin e foljes *marr* nuk e ka pasqyruar këtë aq pasur në frazeologji. Por në glosa të tjera ai ka përfshirë një frazeologji relativisht të pasur me strumbullar këtë folje. Ja disa shembuj: me marrë *mët* (161, 399, 204, 879); ~ *n'ciaf* (846, 153); ~ *ërzin* ciches (845, *stuprare*); ~ *vesct* (380,53); ~ *ndéper* (*n'eper*, *ndër*, *nde për*, *nner*) *kambët* (*kamt*) (939, 304, 200, 122, 802); ~ *ëeren* (259, 30); ~ *zembër* (*zemër*) (93, 190, 392, 224); ~ *giak* ((697); ~ *sciprtin* (228); ~ *dheen o fuscen* (806).

Tek Rosi vihet re dhe një tendencë për ta dhënë komponentin e dytë emër, që bashkëvete me foljen *marr*, në trajtën e shquar, gjë që prish në fakt karakterin frazeologjik të shprehjes dhe e rikthen këtë në një bashkim të lirë fjalësh, p.sh.: me marrë nussen (200); ~ frighen (316); ~ rrughen (373) etj. Gjithashtu nuk janë fakte të shqipes një radhë ndërtimesh që jepen si shprehje analoge me fjalë të italishtes, si: me marr bukure-fial (informarsi, 356); ~ dien (aguzzare l'ingegno 800); ~ madhniin (disauttorizzare, 187); ~ scpressen (isparabile, che non si puo sperare, 376) etj. Ky ngatërrim vjen nga që autori nuk ka njohur veçoritë e frazeologjisë shqipe. Me këtë kuptohet edhe vënia, në të njëjtin plan me frazeologjizmat e vërteta, e bashkimeve të lira të fjalëve, p.sh. me marr gjithçka (350); ~ me thoit (295); ~ për së dyyti (684); ~ me terfurk (356); (3) *prapë* (696); ~ *prei gnegnit* me dhan tietrit (837); ~ *scpatën n'door* (310); ~ *giaja giaall* (186); ~ me dham (9) etj., — duke dashur të japë në shqipe kuptimin e shprehjeve a fjalëve italiane.

Fjalori i Jak Junkut²⁾ ka dhënë vetëm ato që kanë karakter më të theksuar idiomatik. Por në krahasim me Rosin, Junku është më i saktë në zgjedhjen e frazeologjisë. Ai jep vetëm frazeologjizma që i ka shqipja në përdorim, pa i ngatërruar me bashkimet e lira, me proverbat e fjalët e urta dhe në rastet e përdorimit të fjalës bazë në kontekste të ndryshme. Gjithashtu, kombinimet më pak të ngjizura autori i fjalorit i jep në fund të paragrafit. Megjithëkëtë, vëllimi i frazeologjisë që pasqyrohet në fjalor është i vogël, mungojnë frazeologjizma tepër të zakonshëm për shqipen, si p.sh. tek folja *marr*: *marr sehten*, *marr përsipër*, *marr zjarr*, *marrë erë*, *marr pjesë*, *marr me-mend*, *ma merr mendja*, *marr më thue*, *i marr mendjen* dikuj, *fjalët i merr era* etj.

1) F. Rossi: *Vocabolarlo Epitrofico-Italiano*, v. I, Roma 1866.

2) Jak Junku: *Fjaluar i voghel Scyp e Itinsct*, N'Skoder, 1895, shih fq. 75.

Në fjalorthet e Dozonit¹⁾ dhe Vajgandit²⁾ vihen re po këto të meta lidhur me frazeologjinë: vëllimi i vogël, renditja e pakriter, mossppjegimi i mjaftueshëm, mungesa e shënimeve stilistike dhe e ilustrimeve etj.

Tek Hahn³⁾ krahas frazeologjizimeve më *mori malli, më mori koka erë, marr erë, marr ndëpër këmbë, marr vesh, marr më syshë, murr zjarr, marr malet, më miren mënt, i miret goja*, merren si të tilla edhe bashkime të lira fjalësh ose bashkime fjalësh, ku folja *marr* hyn në një kuptim të ri, si p.sh. "kur e zure, kur e *more*?; sot *mora* një kartë; *mora* një ka; nëntë sahat i *muar* për katrë; *merr* zanatin; mbreti *mur* Shqipërinë; *u mora* e vojta ndë Stamboll; ; *mirëm t'i themi, po më vjen turp*". Kjo përzjerje vjen nga që nuk respektohet ndarja e frazeologjisë në një vend të veçantë në fjalor, nuk kategorizohet frazeologjia sipas tipave, nuk bëhet dallimi i kuptimeve derivate nga ato derivate-frazeologjike të fjalëve, kështu që frazeologjia shërben në fjalor thjesht si mjet ilustrues i kuptimeve të fjalëve dhe i përdorimeve të tyre në bashkëvjatje me fjalë të tjera.

Edhe Pedersen⁴⁾ në glosarin e vet, krahas frazeologjizimeve të *marrtë pesë lekurë, marr grua, marr me të mirë, më mori malli, mori malin, mori dynjanë* (fjala), *marr udhën, marr vesh, më merren këmbët*, jep radhazi dhe përzjerje me to bashkime të lira fjalësh, ku fjala *marr* ka po atë kuptim si në krye, p.sh. "mori të pesë liratë, mori edhe dhëntë edhe paratë, e mori djalënë, etj", si dhe kombinime fjalësh ku fjala *marr* hyn me një kuptim të ri, derivat, p.sh. "mori uja djalënë (rërëmbu), *muarr* Morenë (shkuan në ..), *mori* Turqinë, *mori* tutje anënë e detit (shkoi...), *mori* e shtroi sufranë" etj.

Më i pasur me frazeologji shqipe ndër fjalorët e F. Kordinjanos është ai shqip-italisht⁵⁾. Në këtë fjalor janë përfshirë pothuajse gjithë frazeologjizmat e fjalorëve të mëparshëm dhe përsëriten po ato gabime e të meta të tyre.

Varfërisht dhe pa kriter e kanë pasqyruar frazeologjinë edhe fjalorët e Lakalendolas⁶⁾, Lukajt⁷⁾ dhe Gazullit⁸⁾.

I pasur në frazeologji, në krahasim me fjalorët e tjerë, është edhe fjalori i Godenit⁹⁾. Këtu ka dhe një farë kriteri edhe në paraqitjen e frazeologjizimeve.

E para, frazeologjizmat foljore jepen bashkë me kundrinat (e drejta e të zhdrejta) që marrin, duke karakterizuar në këtë mënyrë diatezën e tyre. Kështu është dhënë një anë mjaft e rëndësishme për frazeologjizmat, mënyra e futjes së tyre në fjali. Si kundrinë vihen fjalë me kuptim të përgjithshëm (si *gjë, ndonjë send*) ose përemrat (*dikë, dikujt*, trajtat e shkurtëra të përemrave vetorë etj.), p.sh. *me marrë mbi vedi një send* (110); *ja marrë met* (55); *me marrë ndokënd me të mirë* (53); *pa marrë në sy kërkënd* (21); *me marrë ndokujt gjak* (9); *me marrë ndokënd nën hijen e vet* (267); *me marrë gjá përsipër (në dorë, 19)*; *me i marrë dikujt kafshatën prej goje* (392), etj.

- 1) A. Dozon: *Manuel de la langue chkipe ou Albanaise*, Paris 1879, "Vocabulaire Albanais — Français", shih fq. 47.
- 2) G. Weigand: "Alban. — Deutsches und Deutsch-Alban. Wörterbuch", Leipzig 1914, shih fq. 51-52.
- 3) J. G. Hahn: *Albanesische studien*; Alban. — Deutsches lexikon, Jena 1854, shih fq. 63.
- 4) H. Pedersen *Albanesische texte mit glossar*, Leipzig 1895, shih fq. 154.
- 5) P.F. Cordignano: *Dizionario Albanese-Italiano*, Milano 1924.
- 6) A. Lacalendola: *Dizionario di lingua albanese*; Parte albanese-italiane, Palo del Colle, 1934, shih fq. 78.
- 7) L. Lukaj: "Fjaluer Shqyp-Serbokroatisht", Beograd 1935, shih fq. 194
- 8) D.N. Gazulli: "Fjalorth i Ri"..., Tiranë 1942, shih fq. 250.
- 9) M.F.A. Godin: *Wörterbuch der Albanischen und deutschen sprachen*, Leipzig 1930, shih fq. 233.

Së dyti, aty-këtu jepen edhe variantet e frazeologjizmave, ndryshimet formale dhe zëvendësimet me komponentë të tjerë, p.sh. *me marrë për (mbi) të keq* (40); *me marrë emën zà*, me u famosë.. (63); *me marrë male (malin)* (147, 118); *me marrë (zân) për fat* (për burr; për grue) (103); *me i marrë dorë ëkambë, me i ra ndër k mbë* (65); *me marrë hakun (shpagën)* (53) etj.

Së treti, bëhen përpjekje, sadoqë rrallë, për të dhënë edhe kuptimin e frazeologjizmave, përveç në gjermanisht edhe në shqipet, me anë të shprehjeve sinonimike ose të fjalëve të tjera, p.sh. *me marrë uriye, me velë* (117) *me marrë nëpër gojë*, me qekë (131); *me i marrë dorë e kambë*, me i ra ndër kambë (65); *me dhanë (marrë) trup*, me trupnue (374); *me marrë me mend*, me ndie (194); *me marrë fjalët skalapurri*, me kuptue liksht (256) etj. Këto spjegime nga një herë nxjerrin në dritë edhe kuptimet e ndryshme të frazeologjizmave polisemantikë, p.sh. *me marrë mrapa*, me ecë pas (53); *me marrë sysh*, me verbue sytë (blenden, 76) etj.

Megjithëkëto, ka edhe raste kur krahas frazeologjizmave jepen edhe konstruktet jo frazeologjike, si: me u marrë me (pas).... (63); me marrë në vithe (të kalit) (202); me u marrë me punë të botës (152); mos me i marrë punët përnjimend (169); me marrë me vete (149); me marrë për vedi (95) etj. Gjithashtu jepen edhe disa konstruktet që nuk janë fakte të shqipes, si: me marrë dashtuni për dicilin (244); gjithë marrë mirë në sy (150); me marrë grat prej, me çfrytëzue (36); do të marrë lirinë (151); me marrë (ngrënë) bukë (168); me marrë në vegim (entzücken, 123) etj.

Fjalori i Kristoforidhit) nuk shquhet për ndonjë pasuri të madhe në frazeologji. Janë dhënë kryesisht shprehjet që kanë një karakter të theksuar idiomatik, por krahas tyre janë dhënë bashkime frazeologjike si *më merr uria, gjumi, malli, marr e ap, merr dem* (lopa) etj. Nga një herë merren për frazeologjizma konstruktet të lira, si. p.sh. sa merr kjo enë? etj., ku folja bazë ka hyrë me një kuptim të ri(=nxë) si fjalë polisemantike.

Tek fjalori shqip-italisht i Leotit) frazeologjia shqipe është pasqyruar relativisht mirë si vëllim, janë dhënë një numur i madh frazeologjizmash të gjuhës së folur e të shkruar. Përveç kësaj, në fjalorin e Leotit janë dhënë edhe variantet e frazeologjizmave dhe mënyra e përdorimit të tyre.

Po këtu gjithashtu përzjehen frazeologjizmat me konstruktet e lira, ku folja bazë ka hyrë me një kuptim të ri si fjalë polisemantike, p.sh. "si e merr kafë me shumë ose me pak sheqer?; prej shitjes së derrave *mori* dymbëdhjetë mijë franga; *të merr* dy ditë të shkosh prej Sarandë në Korçë; i shkrep një shpirt nga këto që gjeta, nuk *merr*, shkrep një tjetër, gjithashtu; kur e zure, kur e *more*? (quando ti sei fidanzato con lei?); po këndezi as la as *mori*, i qendron qenit; sa *merr* kjo enë?; *jam marrë pas ligjit*" etj.

Leoti përfshin në fondin e frazeologjizmave edhe mallëkimet, urimet, proverbat, sentencat etj., të cilat i jep përzjerë me frazeologjinë e gjuhës, p.sh. ta marrtë djalli shpirtin; djalli ta marrë njeriun; me që na nuk mund të marrim ato që duam le të kënaqemi me ato që marrim; ç'ep, atë merr; ku kishim për të marrë, na muarrë dhe kanë; kush merr e nuk kthen; tjetër herë nuk gjen, etj.

Ndër fjalorët më të pasur në frazeologji dhe që kanë bërë një farë zgjedhjeje sipas disa kriteresh të caktuara është edhe fjalori i shoqërisë "Bashkimi"²³). Në këtë fjalor frazeologjia është dhënë pas spjegimit të kuptimit a kuptimeve të fjalëve, nuk është përzjerë me shembujt ilustrues, bashkimet e lira të fjalëve, proverbat, fjalët e urta etj. Frazeologjizmat janë dhënë

1) K. Kristoforidhi: *Fjalor shqip-greqisht*, Czechoslovakia, 1961, shih fq. 196.

2) A. Leotti: *Dizionario albanese-italiano*, Roma 1937, shih fq. 647.

3) "Fjaluar i Rrë i Shqypes", Shkodër 1908, shih f. 294.

në formë fillestare, neutrale, — frazeologjizmat foljorë në infinitivin, p.sh. *me marrë fushat, me marrë male a malin, me marrë ghakun a t'kécën*, etj.; janë ruajtur veçoritë strukturore të tyre, format e komponentëve, parafjalët etj., p.sh. *me marrë vesh, me marrë m'sysh, me marrë m'thue, me marrë mënnsh, m'u marrë mënnsh*, etj.; jepen rastet e përdorimit të tyre, sidomos kur kanë përdorim të kufizuar, p.sh. kalit *i'a marr ana; me marrë emni a xâni dheen; me m'i, t'i, i'a marrë méet*; me *marrë dem lopët, dhuit skiap, delet dash; me e marrë n'lavd; me m'u, t'i marrë méet; me m'u, t'i, marrë syyt a e paamia; me m'u, t'i marrë kâmët*, etj.

Së fundi po përmendim "Fjalorin e gjuhës shqipe", të vitit 1954. Ky fjalor, si në shumë drejtime të tjera edhe në fushën e pasqyrimin të frazeologjisë, padyshim, qëndron më lart se fjalorët e mëparshëm. Frazeologjia shqipe këtu ka gjetur një vend më të gjerë, ajo është dhënë në një vend të veçantë; kriteret janë më të përpunuara, spjegimet më të plota e më të sakta etj. Por edhe ky fjalor nuk i ka shpëtuar traditës. Për krahasim po marrim gjithënjë ndërtimet me foljen *marr*).

Edhe duke patur parasysh vetëm modelet e dhënë në fjalor nën fjalën titull *marr*, vihet re lehtë se janë lënë jashtë një numur jo i vogël konstruktësh analogë, p.sh. krahas *ja mori këngës* mund të jepej edhe *ja mori vrapit, marr udhë* (nisem), *marr grysh; marr vull; merr fill* (dërrasa); *merr dita* (nis e zbardhëllen) etj.; krahas *fjala mori dhenë* mund të renditej edhe *merr sheshin* ("Të gjitha këto zonja me gushë e shpatulla të zbuluara s'mbanin tyll dhe, me ato mishrat lakuriq që *kishin marrë sheshin*, tregonin me guxim se vinin nga ana më elegante e Parkut" — Xh. Gollsworth: *Saga e Forsajtve*, 224); [*marr rrugët*]; *marr dujkat* (Myz.); *mori dushkun; marr syt'e këmbët; mori tym* puna (fig.) etj.; krahas *marr një sëmundje* mund të shtohet edhe *marr shënjë; merr diell* (gruri); *merr veri* (ajroset); *marr fuqi; merr bukë* (gruri); *mërr faqe* (toka); *i marr krahët* (armikut); *marr vend; marr lajm; marr llasë* (llastohem); *merr formë; marr zotim; marr vendim; marr frikë; marr njoftim; merr valë; merr emrin* (quhet) etj.; krahas më *mori mëntë* nuk janë vënë *ja ka marrë era miellit; e mori lumi; të ka marrë koka erë; i ka marrë mendja erë; e kishte marrë ferra uratën; i ka marrë përrëndia mëntë; me marrë mendsh; i ka marrë era mëntë*, etj.

Mendojmë se nuk duhej të kishin mbetur jashtë edhe shprehjet *marr erë* (nuhas); *merr erë* (mishi), zë erë, bie erë; *merr erë* (puna), zbulohet; *marr erë* (nga kjo punë), di diçka; *merr fund*, përfundon; *marr me t'egër*, trajtoj keq; *marr sytë e iki*, iki ku sytë këmbët; *marr inat, marr zët, urrej, marr përpjetë*, rritem; *merr mish e eshitna*, mishërohet, realizohet një ëndërr; *e marr në dorë një çështje; me marrë krye*, mburrehem, më rriten veshët; *marr ngrykë, ngrykas*, përqafoj; *më mori lëkurën*, më torturoi, më ropi; *marr zjarr*, nxehem (fig.); *marr hakën; marr mbi vete; marr anë me . . .*, bëhem me . . .; *e bukur sa t'i merrje kokën; ka marrë keq koha; marr prapa*, ndjek, pasoj; *e marr me këmbët e para*, e nis keq një punë, etj. etj. Parimi që shprehjet frazeologjike të shpërndahe brenda paragrafit, duke u vënë pas *kuptimeve*, me të cilat lidhen dhe të vihen pas një vize vertikale/, kur kuptimi i përgjithshëm i tyre s'lidhet drejt për drejt me kuptimet e fjalës që spjegohet (shih "Shënime", VI), ka sjellë që të mos përfshihen në një grup të vetëm një sërë frazeologjizmash të një natyre me modelet e dhënë në fjalor. Nëqoftëse këto me të drejtë janë dhënë në vend tjetër, sipas parimit të fjalës bosht, ahëre këtu ndjehet e novojëshme të jepeshin me referim, ashtu siç është dhënë për shembull shprehja "e merr ana, sh. anë",

1) "Fjaluar i Rii i Shecypes", Skkođer 1908, shih f. 294.

2) Instituti i Shkencave: "Fjalori i gjuhës shqipe" (1954) f. 282.

ose siç janë dhënë pa referim shprehjet i *marr flokët, më mori uria, më mori gjumi, marr një sëmundje, i mori gjak, i mori zanatin* etj.

Lidhur me kriteret e zbatuara në pasqyrimin e frazeologjisë në "Fjalorin e gjuhës shqipe" (1954) shtojmë edhe këto dy shënime:

1. Ka raste kur përzjehen tipat e frazeologjizmave nëmes tyre dhe frazeologjizmat me bashkimet e lira të fjalëve (që janë dhënë si shembuj) ose me shembujt që ilustrojnë përdorimin e fjalës bazë në kuptimin e dhënë. Kështu, p.sh. në rendin e kuptimeve të fjalës *marr* (d.m.rth. para vijës vertikale /), jepen si të të njëjtës natyrë e funksion bashkimet e lira *mori kësulën e shkoi; mori qytetin, kalanë; mora një letër; mora një ka; mori e tha; mori një shërbyes; pela mori; sa merr kjo enë?; për hajdut më merr ti mua?*, — me bashkimet frazeologjike *mora rrugën; lopa mori dem; ka marrë vapë*, dhe njësitë frazeologjike *fjala mori dhenë; marr tatëpjetën* (në kuptimin figurativ). Nga ana tjetër në paragrafin e frazeologjisë (pas vijës vertikale /) dhe përzjerë me frazeologjizma janë dhënë kombinime fjalësh, ku folja *marr* nuk krijon ndonjë unitet frazeologjik me fjalët e tjera, p.sh. *m'është marrë zëri; merr me dalë, po s'mundet; ç'merr prej Elbasanit deri në Tiranë; ai merret me folklor*. Si pasojë disa shprehje përsëriten, sepse lidhja e shprehjes me këtë apo atë kuptim të fjalës titull nxjerr nevojën e përsëritjes së kësaj shprehjeje sipas kuptimeve të ndryshme të fjalës bazë si edhe në paragrafin e veçantë të frazeologjizmave "që s'lidhen drejt për drejt me kuptimet e fjalës që spjegohet", siç ndodh me shprehjen *ja mori këngës* (fq. 292, m., tek kuptimi "nis, filloj") dhe *ja marr këngës* (fq. 292, d., spjeguar "ja nis").

2. Zbatimi i parimit të shpërndarjes së shprehjeve frazeologjike brenda paragrafit sipas kuptimeve dhe të një pjese të tyre pas vijës vertikale, na duket se i ka lënë shteg të hapur edhe klasifikimit subjektiv të kuptimeve të fjalës bazë. Së pari, vendosja e frazeologjizmave shpërndarë sipas kuptimeve të fjalës kryesore ka çuar në përzjerjen e kuptimit të drejtpërdrejtë e atyre derivate të fjalës me kuptimet frazeologjiksht të lidhura të saj. Folja *marr* si kuptime të mirëfillta (të drejtpërdrejta e derivate) ka kuptimet 1,2,3,4,6,7,9,10, kurse të tjerat janë kuptime frazeologjiksht të lidhura, të cilat folja *marr* i nxjerr vetëm në lidhjet frazeologjike. Së dyti, duke zbatuar këtë parim, shumë shprehje që janë dhënë në paragrafin pas "vijës vertikale" mund të lidhen me këtë apo atë kuptim të fjalës *marr*, p.sh. *marr hua* me kuptimin 3, *marr me dalë.. ç'merr prej Elbasanit..* me kuptimin 6, etj. Së treti, sikurse, kuptimet 5,8,11 mund të renditen edhe një sërë kuptimesh të tjera frazeologjike të foljes *marr*, p.sh. 12) zë (fig.) *kjo stofë s'merr bojë*; 13) kap (fig.) : *më mori uria, më mori gjumi, më merr malli*; 14) ngjitet: *marr një sëmundje*; 15) mësoj: *marr zanatin*; 16) heq: *marr gjak*, etj. Ky varg kuptimesh kështu nuk do të kishte një kufi objektiv, po të vazhdonim të renditnim kuptimet frazeologjiksht të lidhura të fjalës *marr*.

Të tilla janë në vija të përgjithëshme të metat tek disa nga fjalorët e gjertanishëm të shqipes, lidhur me pasqyrimin e frazeologjisë. Studimi i kësaj çështjeje më thellë edhe me shembuj të tjerë do të zbulojë padyshim edhe probleme të tjera.

Po këto vërejtje u përkasin edhe botimeve të ndryshme në revistat e para dhe pas çlirimit nën rubrikën "fjalë dhe fraza të pambledhura".

Gjithësa u tha tregon se gjer tani nuk ka pasur një koncept të qartë dhe unik mbi frazeologjinë e gjuhës, vëllimin, tipat e saj, veçoritë semantiko-formale etj. Kanë munguar studimet me karakter përgjithësues, frazeologjia e gjuhës shqipe në pjesën më të madhe nuk ka qenë e grumbulluar, nuk ka pasur kritere të qarta dhe unike lidhur me klasifikimin dhe pasqy-

rimin e saj në fjalorë të ndryshëm, në mvartësi nga tipi i fjalorit, vëllimi i tij etj.

Gjendja jo e kënaqëshme e studimeve të gjertanishme në lëmin e frazeologjisë shqipe, të kuptuarit e ndryshëm të shumë çështjeve të frazeologjisë, — nga njëra anë dhe nevoja e përcaktimit të kritereve më të drejta, për pasqyrimin e këtij fondi ndër fjalorë të ndryshëm, — nga ana tjetër, kërkojnë domosdo një tok punimesh përhkruese e sistematizuese, analitike e përgjithësuese për frazeologjinë e gjuhës shqipe, punime që të përcaktojnë qartë, mbi materialin konkret të shqipes, nocionet themelore për frazeologjinë e gjuhës, veçoritë e saj, kufijtë, tipat, mënyrën e formimit të modeleve të ndryshme, mënyrën se si të pasqyrohet ndër fjalorë etj.

Prandaj na duket e nevojëshme të shtrojmë disa probleme të karakterit të përgjithshëm, probleme të strukturës semantike, të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmeve të gjuhës shqipe.

I. — PROBLEME TË KARAKTERIT TË PËRGJITHSHËM.

Trajtimi teorik i frazeologjisë në këtë kapitull, përmbledhtas, na u duk i nevojshëm për të përcaktuar se ç'material do të kemi parasysh gjatë punimit, si frazeologji e gjuhës, ç'e dallon atë nga bashkimet e lira të fjalëve dhe nga frazeologjia letrare (proverbat, gjëzat, fjalët e urta etj.), si dhe për të dhënë disa veçori të përgjithëshme e të pjesëshme të frazeologjisë së gjuhës etj.

Lidhur me konceptin mbi frazeologjinë e gjuhës, në linguistikën e sotme botërore ka mendime të ndryshme. Disa lingvistë¹⁾ në vëllimin e frazeologjisë, përveç bashkimeve të qëndrueshme të fjalëve të formuara historikisht, të leksikalizuara ose me tendencë leksikalizimi dhe ekuivalentë semantikë të fjalëve, përfshijnë edhe elementet e folklorit, — proverbat, fjalët e urta, gjëzat, citatat e proverbializuara etj. — Të tjerë²⁾ janë kundër këtij mendimi dhe kanë një koncept më të ngushtë për frazeologjinë e gjuhës, duke nxjerrë nga vëllimi i saj frazeologjinë letrare. Mendimi i fundit na duket më i drejtë³⁾. Për ne paraqesin interes gjuhësor ato bashkime të qëndrueshme fjalësh, të formuara historikisht dhe të kristalizuara si njësi kompakte, që nga ana kuptimore janë ekuivalente me një fjalë të vetme.

Si tipare esenciale dalluese të këtyre ekuivalentëve të fjalëve duhet të konsiderohen uniteti semantik i tyre, funksioni gramatikor dhe karakteri historik i formimit.⁴⁾

§ 1. — Frazeologjizmat gjuhësorë nga pikëpamja e komponentëve janë

1) Shih p.sh. В.В. Виноградов: *Об основных типах фразеологических единиц в русском языке*, в сб. „А.А. Шахматов“, М., изд-во АН СССР, 1957; Н.М. Шанский: *Фразеология современного русского языка*, М. 1963, e të tjerë.

2) Shih p.sh. С.И. Ожегов: *О структуре фразеологии*, „Лексикографический сборник“, вып. 2, М. 1957, Изд-во АН СССР, e të tjerë.

3) Për këto edhe për temat e përdorur si „frazеологji“, „frazеологji e gjuhës“, „frazеологjizëm“, „grup frazeologjik“, „njësi frazeologjike“, „unitet frazeologjik“, „togfjalësh frazeologjik“ etj. ka koncepte dhe aplikime të ndryshme; shih edhe Charles Bally: *Traité de stylistique française*, II ed. vol. 1, I, p. 64.

4) Shih edhe А.И. Смирницкий: *Лексикология английского языка*, М. 1957, гл. 6; В.С. Виноградов: *О некоторых выдоизменениях исходной модели фразеологического сочетания в предложении*, në „Романская филология“, ЛУ 1957, 131-145; Б.А. Ларин: *Очерки по фразеологии*, në „Очерки по лексикологии, фразеологии и стилистике“, ЛУ 1956, 200-225; И.Н. Тимескова—Шахова: *Наблюдения над фразеологическими единствами французского языка*, në „Романская филология“ ЛУ 1957, 109-117, e të tjerë.

bashkime fjalësh, togfjalësha, d.m.th. në përbërjen e tyre hyjnë jo më pak se dy fjalë emërtonjëse, p.sh. *marr vesh, vë re, hedh sytë, "bëhet fjalë se do të ketë kohë të keqe"* (flitet), *ballë për ballë, bres pas brezi, fus hundët, i bie më qafë, hap zjarr* (në luftë), *marr nëpër këmbë, e kishte marrë ferra uratën* etj. R.A.Budagov thekson se "idioma nuk është e ndarë nga koncepti i togfjalëshit, prandaj s'mund të biem dakord me ata linguistë, të cilët flasin për karakter idiomatik në fjalë të veçanta. Një përdorim i tillë i fjalës qit ngatërresa në gjithë problemin e idiomatikës (veçanërisht çon në ngatërërimin e idiomave me përdorimin figurativ të fjalëve të veçanta¹⁾". Prandaj nuk duhet të merren si frazeologjizma rastet kur nuk kemi të paktën dy fjalë emërtonjëse, si lokucionet lidhore e ndajfoljore: duke qenë se, për arsye se, sa do që, në lidhje me, deri sot, nga nalt, me të shpejt etj. Komponentët në këto lokucione nuk kanë as karakter figurativ. Po kështu nuk duhet të përfshihen në frazeologjinë e gjuhës fjalë a lokucione thirrrore, përhëndetje, mallëkime etj. të këtij tipi: ku po shkon?, ku je nisë?, prej kah vjen? po shkoj në . . . , po vij prej . . . , hajde të shkojmë, mos u largo! ndalu!, pusho!; zdryp!, padyshim, ah faqezi!, ç'turp! etj., të cilat gjithashtu nuk përbëhen nga dy a më shumë fjalë emërtonjëse, ose nuk kanë karakter figurativ²⁾.

Togfjalëshat frazeologjikë janë bashkime të *qëndrueshme* fjalësh. Në bashkimet e lira të fjalëve fjalët vendosen në marrëdhënie midis tyre aty për aty, gjatë të shprehurit të mendimit, në momentin e komunikimit, në përshtatje, sigurisht, me ligjet e gjuhës. Kuptimi tërësor i togfjalëshit të lirë del nga mbledhja e thjeshtë e kuptimeve të fjalëve përbërëse. Kjo gjë del më e qartë në zbrëthimin e një fjalie në togfjalësha, p.sh. unë lexova shpejt letrën e shkurtër të babit: unë lexova / lexova shpejt / lexova letrën / letrën e shkurtër / letrën e babit; kuptimi i këtyre togjeve del nga shuma e kuptimeve të fjalëve përbërëse, kurse kuptimi i fjalisë nga shuma e kuptimit të togjeve të saja përbërëse. Në bashkimet e lira të fjalëve fjalët ruajnë pavarësinë e tyre kuptimore dhe me të njëjtin kuptim mund të hyjnë edhe në bashkime të tjera të lira fjalësh³⁾, p.sh. lexova letrën / lexova gazetën / lexova shpejt / etj. Në bashkimet e lira të fjalëve nuk ka ngurosjë të formave të fjalëve. Fjalët lidhen dhe ndryshojnë në bazë të rregullave gramatikore dhe nuk "ngrijnë" në një formë historikisht të kushtëzuar. Kurse në frazeologjizmat e gjuhës vihen re karakteristikat të tjera: *Së pari*, lidhja e fjalëve në ta nuk bëhet aty për aty, në momentin e komunikimit, por është bërë me kohë, historikisht, p.sh. *marr pjesë* etj. *Së dyti*; kuptimi tërësor i frazeologjizmit del jo nga shuma e thjeshtë e kuptimit të fjalëve përbërëse, po nga shkrirja kuptimore e tyre, nga një lidhje e brendëshme e komponentëve, që çon në një kuptim të vetëm. Mjafton të vërehet për këtë gjë frazeologjizmi *marr vesh* gjatë zbrëthimit të kësaj fjalie në togfjalësha: nuk e *mora vesh* mirë shokun (ç'tha): nuk e *mora vesh* /

1) P.A. Будагов: Введение в науку о языке, М. 1958, 105.

2) P. F. Cordignano, në "Lingua Albanese" (1931) i merr këto si frazeologjizma. Krh. edhe H.H. Амосова: Основы английского фразеологии, ЛУ 1963, f. 125 (bashkimi i një fjale shërbyese me një fjalë denominative) dhe f. 131 (tipi *to come in angl.*, — bashkimi i një folje me një postpozitiv). Shih edhe vërejtjet e mësipërme për gramatikën e shqipes, në disa prej të cilave, nën termin "lokucion", "shprehje" përfshihen si lokucionet gramatikore (parafjalore, lidhore, ndajfoljore), ashtu edhe frazeologjizmat e tipit që studjojmë.

3) Nuk duhet harruar këtu sigurisht konteksti, në të cilin fjala mund të jetë me kuptim primar, por mund të jetë dhe me një nga kuptimet derivate, figurative. R. A. Budagov, vep. e cit. f. 17, e vlerëson shumë rolin e kontekstit në përcaktimin e kuptimit të frazeologjizmit kurse N.N. Амосова (vep. e cit. f. 16) nga pëlëpamja kontekstuale e quan frazeologjinë si "shkenca mbi njësitë e kontekstit të përhershëm",.

mora vesh mirë / morá vesh shokun/; pra, ky bashkim hyn në fjali në një formë të gatëshme, sikurse fjalët dhe nuk çpërbëhet në togfjalësha të ndryshëm. *Së treti*, tek frazeologjizmat e gjuhës fjalët e kanë humbur plotësisht ose deri diku pavarësinë e tyre semantike; po të çkëputen nga togu ose po të vihen në lidhje të tjera ato zakonisht kanë ose marrin tjetër kuptim, p.sh. krh. *është e udhës t'i shkojmë për vizitë: udhë / bëj udhë / udhë e gjerë / etj.* "Puna është se deri në ç'shikallë fjalët, që hyjnë në këtë apo atë bashkim humbasin pavarësinë e tyre në sistemin e së tërës, në vetëdijen e njerëzve që përdorin ato shprehje. Në idiomat humbja (e pavarësisë së fjalëve — J. Thomaj) është e plotë, në bashkimet frazeologjike vetëm e pjesëshme. Duke e menduar idiomën si një të tërë, zakonisht folësit nuk mendojnë për kuptimin e pjesëve të saja të veçanta".¹⁾ Pra, në frazeologjinë e gjuhës lidhja kuptimore e elementëve përbërës është më e fortë; po të priset kjo lidhje, ahëre priset frazeologjizmi dhe fjalët të çkëputura kanë tjetër kuptim; le të vërehen edhe shembujt: gruri po të *marrë bukë* nuk ka *dëm* nga shiu, ai që është trim e *merr vdekjen në sy* etj. Uniteti i komponentëve i bën ato njësi unike, si nga përmbajtja, ashtu edhe nga forma, d.m.th. njësi që shprehin një kuptim të vetëm leksikor dhe që zakonisht luajnë rolin e një pjese të vetme të fjalisë. *Së katërti*, fjalët ndër frazeologjizma shpesh herë ngurosen në një trajtë të caktuar. Nga ana e përmbajtjes ato kanë një kuptim të kushtëzuar ose të lidhur frazeologjikisht (e përgjithshme) dhe nga forma një trajtë të caktuar e të pandryshueshme (e pjesëshme). Për këtë mjafton të vërehet se si duhet të mbetet në një formë të caktuar fjala *sy* në secilin prej këtyre shprehjeve frazeologjike të shqipes: *m'u errën sytë, shkel synë, ia bëj me sy, mbyll sytë* (vdes), *mbyll një sy, më ra në sy, s'kam sy e faqe, hap sytë!, s'ma mbush synë, mos i jep sy, si e ke synë, merr më sysh* etj.

§ 2. — Përgjithësisht frazeologjizmat burojnë nga bashkimet e lira të fjalëve, të cilat me kohë janë ngurosur, janë shkruirë në një kuptim të vetëm dhe janë kristalizuar si elemente unike. Praktika e komunikimit të njerëzve me anë të të folurit i ka sjellë ata në një formë pak a shumë të fosilizuar. "Në togfjalëshat e pazbërthyesëm, — shkruan akad. V.V. Vinogradov, — lidhja e komponentëve mund të bëhet e qartë nga pikëpamja historike, por ajo është e pakuptueshme; e pamotivuar nga pikëpamja e sistemit të gjallë të marrëdhënieve të sotme gjuhësore. Togfjalëshat e zbërthyesëm paraqiten si mbeturina të periudhave të kaluara të zhvillimit të gjuhës".²⁾ Këtu V. V. Vinogradov ka parasysh tipat e pamotivuar, siç janë idiomat, por një premisë e tillë, vetëm si tendencë, vihet re edhe në tipa të tjerë, sidomos në ata kalimtarë nga njësi në përngjitje frazeologjike.

Megjithë këto, frazeologjizmat gjuhësorë ruajnë edhe disa veçori të togfjalëshit të lirë, siç është p.sh. formimi me dy ose më shumë fjalë kuptim-plote, shprehja e lidhjeve (midis sendesh, sendit e cilësisë, veprimt e cilësisë së veprimt etj.), ruajtja e karakterit të lidhjeve sintaksore midis fjalëve edhe gjatë vendosjes së tyre në fjali etj.

§ 3. — Tipari më esencial i frazeologjizmit të gjuhës është uniteti semantik³⁾. Frazeologjia e gjuhës përbëhet nga *ekuivalentë kuptimorë të fjalëve*. Kuptimi tërësor i frazeologjizmit del nga lidhja e brendëshme dhe shkruirja kuptimore e komponentëve të tij ose transformimi kuptimor i kombinimit në tërësi. Në këtë kuptim, është më e drejtë që në frazeolo-

1) R. A. Budagov, *vep e cit.*, fq. 102

2) В.В. Виноградов: *Русский язык*, Учпедгиз, — 1947, 21. Në këtë punim është pranuar, në vija të përgjithëshme, klasifikimi i frazeologjisë sipas V. V. Vinogradovit.

3) Shih tek S. I. Ozhegov, *art. i cit.*, § 19.

gjinë e gjuhës të përfshihen ato bashkime të qëndrueshme fjalësh që kanë karakter emërtonjës, d.m.th. që shprehin nocione si:

a) Nocione mbi sende, fenomene, si frazeologjizmat që janë të një vlere nga ana kuptimore me një emër, p.sh. "Të zanët e nfill të Ungjillit shenjtë porsì shkrou Luka cap. XXII" (Buz. XXX 37a)¹⁾; "Në mëniët e n së dashunit së keq, e n gjithë vollundetje së keqe". (Buz. XVIII 20a); "Kush e di sa keni vuajtur. . / Gynteri — Për këtë s'kam të drejtë të qahem. Të zezat e ullirit . . ." (Q. Buxheli "Dueli", "Nëndori" 1963, 12, 65); " . . ma reshñë afro një vit me radhë, me romuze e me të kthyer kokën mënjane, kur më shihnin". (Sh. Musaraj, "Isha unë Çobo Rrapushi", 20); "s'kalohet jeta me të marrë hua të tjerëve" (po aty); po kështu mund të përfshihen në kategorinë e frazeologjizmave emërorë disa terma shkencorë të përbërë, si gjuhë lope, gjurmë mushke, hiith dekmi, zburth dërhi etj. (emërtime bimësh, shih "Albania", 1900, nr. 4, 89) etj. Siç shihet nga shembujt e sjellë më sipër, një pjesë e frazeologjizmave emërorë dalin nga kthimi i tipit foljor të frazeologjizmatve në atë emëror, nëpërmjet të kalimit të komponentit folje në emër foljor asnjanes ("Të zanët e nfill . . ."). Tipi emëror i frazeologjizmave në shqipe nuk është shumë i pasur dhe produktiv.

b) Cilësi sendesh, siç janë frazeologjizmat mbiemërorë, p.sh. "ky pesë para djalë të kujtonte një fije bari...." (N. Prifti "Lëkura e ujkut", 47); "ra fjala për fshatin tonë që i ka shtëpitë lesh e li" (po aty, 41); njeri me lugë në brez; ky njeri është folë e qesh; "Tregëtari uli kokën dhe iku me bisht në shalë . ." (i turpëruar, B. Dede: Përralla e tre vëllezërve, 1958, 6); "Është dreqi vetë" (=i zgjuar, Çajupi: Mëmëdheu, 112); "Një njeri, lindur për shat, / kish në kopshtë në një fshat . ." (id. 112); "Jeni një njeri dogmatik, një njeri fanatik që besoni me krye të ngjeshur të gjitha ato që ju thanë në shkollë . ." (F. Konica: Dr. Gjëlpera, 57); "Dr. Gjëlpera hodhi një sy përpjetë, dhe, i pavënë re, vuri re një grua të lulëzuar nga shëndeti" (id. 52); "Kështu është ai, i lirë në miell e i shtrënjtë në krunde"; "Këto që ka veshur janë bërë për faqe të zezë (shumë të këqia, P. Nilin: Afati i Provës, 13); " . . ai u shtrua, u bë si pulë e lagur (id. 35); "i lemë me këmishë ky" etj. Këta frazeologjizma janë ekuivalentë kuptimorë të mbiemrave. Ndër ta ka dhe tipa që mund të krahasohen semantikisht edhe me ndajfolje, si me krye të ngjeshur (=me kokëfortësi), me bisht në shalë (me turp) etj.

c) Një veprim si proces, si frazeologjizmat ekuivalentë semantikë me një folje, p.sh. "Përse mbë ty, Zot, paçë shpënësë...." (Buz. XVII 17a); "Ty vetëmë rae ndë kat, e përpara ty bana keq; . ." (po aty); "Në mbajtësh mend të këqiatë". (Buz. XX 23a); " . . as mos padit as mos mer ndërë kùjuaj." (Buz. XXI. 26 b); " . . tue bām bē reshim Krishtnë.. ." (Buz. XXII 28b); " . . as për të nukë të rā ndë mend" (Buz. XXIII 29a); "Mā parë zamë nfill mbë Apostojt të Tinëzot, . ." (Buz. XXVI 35b); "Këmbën e t'et rreh të zerë", (N. Frashëri, "Histori e Shëndërbeut", 62); "Un'e gjetal çupat janë femra, u pjell mëndja ! (Çajupi, "Vepra", 251); "S'mba mënt? u deje pa pirë?" (po aty 129); "Sot, mëndja m'u thye" (po aty 147); "Mua të më venë brirë!" / tha, dhe goditi të birë!" (po aty 89); "Pastaj i nguli sytë udhës, që çonte në Trokth, sikur të priste të vinte njeri andej" (J. Xoxa, "Lumi i vdekur"); " . . i gëpi sytë bregdetit" (Z. i Popullit, 22.I.61, III); "Qemali s'bënte fjalë as për dashuri, as për politikë" (Sh. Musaraj, vep. e cit., 4); " . . tjetër thonë e tjetër bëjnë, prandaj nuk u duhet zënë

1) Sipas transkriptimit të Prof. E. Çabejt, dorëshkrim në arkivin e Institutit të Historisë e Gjuhësisë.

besë" (po aty, 16); ". . . gazeta e tyre... përveç të tjerave, të hap edhe sytë në shumë gjëra?" (po aty); "I kanë arrestuar të fejuarën, Teuta Malin, në ta ka zenë veshi". (Q. Buxheli, vep. e cit., 32); "Qysh t'ja bën një këtëja që t'i ze gojën, që të mos më thotë më" (Senembelli-Fier, "Përralla popullore, mbl. K. Harito, arkivi i Inst. të Folklorit, v. I, 1952, 70); ". . . u ra koka ndër këmbë atyre na aseti, se mbenë kallp ato, mbenë në baltë" (po aty, 64); "Dr. Gjëlpera merrte me ment jetën e saj të unjët e të errët" (F. Konica: Dr. Gjëlpera, 52); "të ngulim këmbë pastaj që ajo gjë është ashtu" (ib. 60); *naxjerr nga balta; heq dorë; i janë rritur veshët; zbardh dhëmbët* (qesh); *hedh në dorë; hedh hi syve* (mashtroj); "Se kur lop'e tijë / bën kërdin në grurë, / shokut kryetar / Mos t'i thotë mendja se fshati ha . . . bar" ("Hosteni", 509, I 1964,7) etj.

Tipi foljor i frazeologjizimeve është më i pasuri dhe më produktivi në gjuhën shqipe.

Emërtimi mund të bëhet për një veprim që kryhet ose për një veprim që nuk kryhet, për një gjendje që ekziston a për një gjendje që nuk ekziston, prandaj në frazeologjizim formalisht shprehen edhe pjesëzat mohuese e pohuese, p.sh. *mos me ça kryet, mos me pasë mend* etj.

Por kjo nuk do të thotë se këto shprehje nga kuptimi janë ekuivalente me fjalinë. Duhet patur parasysh se fjalja, — pra edhe proverbat, gjëzat etj., — pohon ose mohon një mendim të plotë, shpreh gjykim, kurse frazeologjizmi foljor vetëm emërton një veprim si proces e nuk shpreh gjykim; ashtu sikurse foljet përgjithësisht kur merren në një formë neutrale (infinitiv apo pjesore). Kjo gjë kuptohet më mirë kur foljen e këtyre shprehjeve e vemë në një formë neutrale, p.sh. në infinitivin gegërisht: me *hedhë hi syve* (emërtimi i mashtrimit si proces), *me marrë vesh, me vue re* etj., sikurse tek foljet me *mashtrua, me kuptua, me shikua* etj. Me këtë kënd pamjeje nuk përfshihen në vëllimin e frazeologjisë së gjuhës proverbat, gjëzat, citatat e proverbializuara etj., përgjithësisht frazeologjia letrare.

Megjithatë do të ishte praktikisht e vështirë dhe parimisht jo shkencore të vihej një hendek i qëruar në mes frazeologjisë letrare dhe asaj gjuhësore. Ka plot raste të dyshimta, të përziera dhe kalimtare, që mund të trajtohen edhe si elemente të frazeologjisë letrare edhe si elemente të frazeologjisë gjuhësore, sidomos në rastet kur frazeologjizmi është i zgjeruar me fjalë të tjera në fjali, p.sh. s'i *bihet murit me krye, shkon i njomi me të thatin, i bahet ferra Brahim* (trëmbet shpejt), *i bën hesapet pa hanxhinë* (ngutet), *ky njeri as të ftoh as të ngroh* (i palezet), *jam as me buaj as me qe* (në dilemë) etj. Gjithashtu shumë proverba e të thëna shqipe kanë si gjymtyrë të tyre frazeologjizma gjuhësorë, p.sh. *kush s'ka kohë / ka këmbë, kush i bën varrin shoqit / bie vetë brenda, der sa t'çohet fmija n'kambë të vjen shpirti ndër dhambë* etj.

R.A. Budagov thekson se "proverbat dhe fjalët e urta popullore gjithashtu ndikojnë me kuptimin e tyre unik (në formimin e bashkimeve të qëndrueshme të leksikalizuara — J. Th.), por fjalët e veçuara që hyjnë në to, zakonisht nuk e humbasin pavarësinë e tyre"¹⁾.

d) Duhet të përfshihen në vëllimin e frazeologjisë së gjuhës edhe ato bashkime të qëndrueshme fjalësh me funksion emërtonjës, që shprehin një cilësi të veprimit a një rrethanë të veprimit, duke luajtur kështu nga ana kuptimore rolin e një ndajfoljeje, p.sh. ". . . e Zoti uit i Sionit k̄a me klenë ndë farë të farëvet". (Buz. XX 24 b); "Përse natë e ditë u randuo dora

jote përmbi muo" (Buz. XVI 16a); "E shkonte jetën hiq e mos e këput.." ("Nëna e erërave", 52); ". . . hidheshin me kokë në torbë aty ku i thërriste zëri i mëmëdheut" (Sh. Musaraj, vep, e cit., 17); "Qemali e donte si gjithënjë me mish e me shpirt." (po aty, 4); "Ç'budallallëk! Të shpëtosh në front e të shkosh dhjamë qeni (=për dhjamë qeni) duke shkuar me leje" (Q. Buxheli, vep. e cit., 43); "Pastaj do gjej rastin dhe do t'ia mbath nga sytë këmbët." (po aty 12); ". . . kokë krisur që të mbeten në qafë kot së koti, komshi që grinden për mustaqet e Çelos." ("Hosteni", 17.XII.63, 7); "po ta them me zemër të çiltër (=singerisht); U zunë për dy pare spec" (gaz. "Bashkimi", 4/7/1963, II); e kam shtëpinë atje ku ha pula gur (shumë larg); retë e bardha shkëlqenin sa të mernin sytë (shumë); pse të hynte dhe ai pesë para në grosh (kot); ka këtu sa të hanë qentë (shumë); përpiqet me ç'ka në dorë (me çdo mjet); flet qesh e ngjesh (me thumba); flet kodra pas bregut (kot); e pagoi si frëngu pulën (shumë shtrenjt); e piu sa çel e mbyll synë (shumë shpejt) etj. Edhe tipi ndajfoljor është i pasur dhe produktiv në shqipe!).

Shtojmë se në përcaktimin e konceptit të frazeologjisë së gjuhës dhe të vëllimit të saj, e sidomos për klasifikimin e frazeologjizmave, përveç këtyre veçorive të përgjithëshme duhen marrë parasysh edhe disa karakteristika të pjesëshme të togfjalëshave frazeologjike, siç është çështja e karakterit figurativ të komponentëve, çështja e motivimit dhe shkalla e ruajtjes së pavarësisë semantike e formale e komponentëve.

§ 4. — 1) Karakteri figurativ i komponentëve përbërës. — Kjo nuk është një veçori absolute për gjithë frazeologjinë. Në tipin emëror të frazeologjizmave të shqipes, sidomos në termat e përbërë historikë, politikë, gjeografikë e të shkencave të tjera, — huazime strukturale nga gjuhë të tjera (kalke), — fjalët hyjnë në bashkëlidhje me kuptimin e tyre të drejtpërdrejtë; jo derivat-figurativ, si në termat modernë *stacion telefonik, magazinë popullore, punë dore, ditë pune, komiteti ekzekutiv* etj. (Por dhe në këto formime ky parim nuk është absolut. Në terma të tillë si *pikë e vdekur* (fiz.), *shtylla kurriçore* (anat.), *pikë zjarri* (usht.) etj. jo të dy komponentët kanë hyrë në kombinim me kuptimin e drejtpërdrejtë). Për shqipen ky model përgjithësisht nuk është karakteristik. Ajo që i bën unike këto bashkime është kryesisht funksioni i tyre si njësi të vetme sintaktike.

Në tipa të tjerë njëri ose të gjithë komponentët hyjnë në bashkëlidhje me një nga kuptimet e tyre derivate ose frazeologjike të lidhura²⁾. Kuptimi derivat i njërit komponent shkrihet me kuptimin e drejtpërdrejtë të komponentit tjetër (tek bashkimet frazeologjike) ose shkrihen kuptimet derivate të të gjithë komponentëve (tek idiomat dhe njësitë frazeologjike) për të realizuar një kuptim unik frazeologjik.

Frazeologjizmat që kanë të gjithë elementët me kuptim figurativ dhe që mund të marrin nuanca ekspresive — emocionale, përbëjnë grupin emëror mbiemëror, foljorë e ndajfoljorë, të ndërtuar me pjesë të ndryshme të ligjëratës. Këta frazeologjizma shpesh herë kanë, përveç funksionit emërtonjës edhe funksionin e të çmuarit, të vlerësuarit të objektit a fenomenit, duke shprehur qëndrimin e ndjenjën e folësit kundrejt këtij objekti.

1) Vlen të përmendet këtu se A.I. Smirnickij shënon që frazeologjizmi dhe fjala kanë të përbashkët veçorinë se janë njësi të gatëshme në gjuhë, po ndryshojnë kryekëput nga karakteri i formimit (shih A.I. Смирницкий: *Лексикология английского языка*, М. 1956, f. 208)

2) Me termin kuptim primar kemi parasysh kuptimin e parë historikisht të fjalës, me kuptim derivat një nga kuptimet e saj figurative dhe me kuptim frazeologjike të lidhur kuptimin që fiton fjala vetëm brenda togfjalëshave frazeologjike. Ato njësi të kontekstit të përhershëm që kanë një komponent me kuptim frazeologjike të lidhur N.N. Amosova i quan *frazema* (vep. e cit., f. 64).

Janë shprehje figurative të përfutuara ose me anë të bashkimit të një fjale në një kuptim derivat me një a disa fjalë të tjera, si p.sh. *bëj durim, bëj qejf, ha ana, merr malcin, fus frikën* etj., ose me anë të leksikalizimit të togfjalëshave të lirë, të kalimit të tyre, nëpërmjet metaforizimit, në togfjalësha frazeologjike, si p.sh. *ve dorë* (në një çështje), *fus hundët* (ndërhyj), *kam gisht* (në një punë), *kthej kurrizin* (braktis), *ngul këmbë* etj. Po i ilustruajmë këto dy raste me disa shembuj nga literatura:

Për rastin e parë: "E feja, qish *ndimë kã me të dhanë?*" (Buz. XXIII 29b); "... // shpirti em *pat shpenesë* mbë Tenëzonë." (Buz. XVII 18b); "Mos *kini besë* mbë zotënjt,..." (Buz. XX 24a); "Lutemi atj qi neve bani e *atj* qi neve na *ep gjellë* me se gjellimë; . ." (Buz. XXVI 36a); "Ajo shërbetoria bisedoi me babën e vajzës pe leckë dhe *pre në ditën* për një muaj. Erdhën që ta marrin." (Inst. i Folkl. "Përralla popullore", mbl. K. Harito në Grykë-Fier, 1952, arkiv. V.I, pj. II, f. 103); ". . del *bën kontroll* në gjithë qytetin . ." (po aty, 10); "Inati na *bën të marrë*,..." (Çajupi, Vepra, 234); "Për këtë shkak, *bën gati* shkrimet . ." (po aty, 255); "Fillova të *vrisa mendjen*: pse është i keq komunizmi, kur ka njerëz kaqë të mirë?" (Q. Buxheli, vep. e cit., 55); "Ma *thotë mëndja* se ai . . . ka genë ndonjë aga zemër-mirë . ." (po aty, 12); ". . *kanë vënë emrin* dhe kushtrim lirie është vërtet." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 16); "Ndofta pse ju *bë qejfi* nga këto fjalë, . ." (po aty, 11) etj. Siç dihet, realizimi i frazeologjizmave të kësaj natyre lidhet ngushtësisht me fenomenin e polisemisë në gjuhë, me lidhjen e fjalëve me kuptime të derivuara ose me lindjen e kuptimeve të reja leksikore (frazeologjike) të fjalëve gjatë lidhjes së tyre. Prandaj edhe vendosja e kufirit polisemi-frazeologji është e vështirë, veçanërisht në raste kalimtare a të ndërmytme. Kjo çështje kërkon një thellim të mëtejshëm.

Për rastin e dytë: ". . e pors i pãgoi nuk *çelunjë gojënë*." (Buz. XVI 16b); ". . ; e përmbi mënit t'anëmiqet mive *ndene dorënë* tande; e muo më shpëtoi e djathta jote". (Buz. XX 23 b); ". . , përse ti mund *dalsh përpara* tit zot me faqe të pãndonjë mner e me faqe të dëlirë n konshiciet sote, . ." (Buz. XXV 23 b); "Mua të më *vënë brirë!*" / tha, dhe gaditi të birë!" (Çajupi, Vepra, 89); "Tana zemër-liga, / më *ou synë* shtriga, / pandaja dështova!" (po aty, 120); "Shini Adhamutn' e mjerë / se ç'heq fatzhu me grua! / Sos *qirinë do t'i mbajë*, / sos të shara të durojë, . ." (po aty, 79); "Ujku shkoi nga kish ardhë, / me *kokë poshtë*, me *bisht në shalë*." "Çajupi, Mëmëdheu, 139); "Mundohuni të më mbushni mëndjen që të *jep dorë*." (Q. Buxheli, vep. e cit., 33); "çohuni! Përndryshe ju a *hodha trutë në erë!*" (po aty); "Nga ata varet — më *tund* mua *këmbët* — që shqiptarët të gjejnë fjalën me njëri tjetrin . ." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 16); "Si është e mundur . . që ai t'i harrojë të gjitha këto dhe të *mbyllë sytë* e të ecij kuturu pas një Partie që po ngatron dynjanë, . ." (po aty, 17) etj.

Të dy rastet, si tipa formimi frazeologjizmas, janë mjaft të pasura në gjuhën shqipe. Do thënë se, veçanërisht me rastin e dytë, del një problem i rëndësishëm: Caktimi i kufirit nëmes togfjalëshit të lirë dhe atij frazeologjik nga njëra anë dhe metaforës letrare (element letrar) e togfjalëshit të leksikalizuar (frazeologjik) nga ana tjetër. Ndërkaq me togfjalëshat me tendencë leksikalizimi, — d.m.th. që ruajnë akoma diçka nga figurativiteti artistik, nga metafora letrare dhe që janë të kufizuara në përdorim si elementë të një stili, të një rryme a të një autori, pra shpesh herë elemente (krijime) subjektive, por që nga ana tjetër, për nga struktura e jashtëme dhe e brendëshme e tyre nuk kanë ndonjë ndryshim nga togfjalëshat e leksikalizuar plotësisht dhe që nuk kanë ndonjë pengesë të pakapërcyeshme

që me kohë të kalojnë në togfjalësha të leksikalizuar plotësisht, — me këta togfjalësha pra, mund të mbahet një qëndrim i dyfishtë, — letrar-gjuhësor. Ata përbëjnë njësitë kalimtare, të ndërmjetme dhe, si rrjedhim, fondin rezervë të frazeologjizmeve të gjuhës. Ja disa shembuj, nxjerrë nga pj. II e romanit "Përpara Agimit" të Sh. Musarajt, botuar në rev. "Nëndori", nr. XI, 1963: ". . . Shqipëria kish mundësi të hiqte nga supi armët e t'i përvishej punës . . ." (45); ". . . s'do mënd që me qeverinë e tij mua do më presë shpata në të dy anët . . ." (38); ". . . nuk e quajnë okupator nazizmin; po përkundrazi, bashkojnë sot zërin me të, për të bashkuar nesër dhe armët kundër popullit". (57); "Apo kërkoni akoma të hidhni gurin e të fshihni dorën . . ." (32); "Ujë në havan po rreh . . . me këtë lloj elementi." (57); ". . . sikur ish i bindur që ajo do të mbante anën e komunistëve dhe ish gati t'i thoshte "fillove ti tani të pështysh në çorbë?" (6); ". . . kur populli të hiqte nga këmbët ferrat e drizat që s'e lenë të ngrerë kokën." (5); ". . . Mid'hat Frashëri e Ajeti nuk janë axhaminj që i bien kaqë shumë këtij çekani . . ." (3) etj.

Siç u tha, si ndërtime kalimtare këto mund të shikohen në një prizëm të dyfishtë, — letrar-frazeologjik. Për dallimin e elementit letrar nga ai gjuhësor ndër frazeologjizmat mund të zbatohen, në vija të përgjithëshme, parimet e dallimit të kuptimit të ri (si element gjuhësor) nga përdorimi figurativ i fjalës (si element i stilistikës letrare)¹⁾.

Probleme të tjera që lindin në tipat e mësipërm, si ato të strukturës formale ashtu edhe të strukturës së brendëshme, karakterizojnë frazeologjizmat gjuhësorë përgjithësisht. Duhet shtuar se tipat e mësipërm janë dhënë mbi bazën e karakterit figurativ të njërit komponent ose të transformimit figurativ të një togfjalëshi të lirë në togfjalësh frazeologjik. Por ndodh në shqipe që të krijohen frazeologjizma edhe me anën e bashkimit të dy a më shumë fjalëve, të cilat hyjnë në këtë bashkim që të gjitha me kuptime derivate (figurative) dhe formojnë frazeologjizmin, p.sh. "E kush nukë le me shkuom fjala e njaj plaku për të dërejtë ndaj të, kinëse aj k̄a e aj s'k̄a." (Buz. XXII 27 a); "Ikn'e muarrë Misirë, / u hante koka për brirë! Çajupi, Vepra, 103); "Emirës iu kujtua se i kish dhënë edhe fjalën Qemalit për të bashkëpunuar në atë revistë, . . ." (Sh. Musaraj, vep. e cit., 156); "Po Ajetit, ama i janë ngulur në kokë fjalët e Mid'hat beut.." (po aty); "Aqë pisk e kish me punët e asaj dite Ajeti sa . . ." (po aty, 3); "Jo me ata bishtkëputurit që u është bërë mendja veri për komunizmin . . ." (po aty 15); shes mënd, bëj ballë, i bëj bisht (punës) etj. Siç shihet, ndër këta frazeologjizma të gjithë komponentët kanë kuptim figurativ, por nga ana tjetër ata nuk janë formuar si rezultat i transformimit të togfjalëshave të lirë në frazeologjikë, meqenëse si togfjalësha të lirë këto bashkime fjalësh nuk kanë kuptim të mundshëm. Le të krahasohen për këtë shembujt *ve dorë; ka dorë, kum gisht, marr në dorë* etj. me shembujt e mësipërm. Këto tri procese të karakterit figurativ mund t'i paraqitnim grafikiisht kështu:

Rasti i parë : $Kf + Kd > KF$;

Rasti i dytë : $(Kd + Kd) f > KF$ dhe

Rasti i tretë : $Kf + Kf > KF^2$).

1) Shih tekstin tonë "Leksikologjia shqipe, U. SH. T. 1961, 8.

2) Kf = fjalë me kuptim figurativ, Kd = fjalë me kuptimin e drejtpërdrejtë dhe KF = kuptim frazeologjik. Parantezat dhe f pas tyre në rastin e dytë shënojnë transformimin figurativ të një të tërë dhe jo të gjymtyrëve veç e veç.

Fjalët që hyjnë në përbërjen e frazeologjizmit mund të çfaqin një nga kuptimet e tyre të derivuara (qoftë edhe figurative) që e kanë edhe veçan ose në lidhje me fjalë të tjera, — p.sh. *ngre krye* a) nuk u bindem urdhërave a ligjëve; b) mëkëmbem, — *Fjalori i gjuhës shqipe*, 1954, 347, ku folja *ngre* hyn me një kuptim derivat figurativ si tek *ngre ushtrinë në këmbë* (po aty), *e ngriti në qiell*, e lëndoi shumë (po aty), *ngre çmimet*, *ngre zërin* (po aty), *ngre ushtar* etj., — ose pikërisht në frazeologjizëm fitojnë një kuptim të lidhur, frazeologjik, që s'e kanë veçan ose në lidhje të tjera fjalësh, si p.sh. *ngre këngë* (pop.) =thur, *ngre në gjyq* (*Fjalori i gjuhës shqipe*, 1954; 347) = hedh, nxjerr, çoj etj.

Duhet theksuar se në shqipet jo gjithënjë krijohet frazeologjizëm kur kemi lidhje të thjeshtë, pa ndonjë njësim kuptimor, të dy fjalëve me kuptim të derivuar (a figurativ), p.sh. *preja pazarin* (cakto çmimin), *pret hollë* (gjykon hollë) etj. (po aty, 429).

Shtojmë se një rol të rëndësishëm lot edhe struktura formale e frazeologjizmit, — kategoria gramatikore dhe format gramatikore të fjalëve etj., — nga njera anë dhe struktura e brendëshme, semantema, desemantizimi etj., — nga ana tjetër, çështje që do të cekem më poshtë.

§ 5. — 2. *Motivimi ose mungesa e motivimit*. — Edhe kjo është një veçori e pjesëshme e frazeologjizmeve. Ka frazeologjizma të shqipes ku nuk mund të kapet lidhja nëmes kuptimit të drejtpërdrejtë të elementëve përbërës me kuptimin tërësor frazeologjik, nuk mund të motivohet arësyeja, burimi dhe rruga e lindjes së kuptimit frazeologjik. Pikërisht ky shkak i bën ato më unike dhe idiomatike, p.sh. idiomat *vë re* — shikoj, *bëj pallë* — bëj qejf, shkoi *dushk për gogla* — kot, i *bie legenit* — flas kot etj. Motivimi ose mos motivimi i idiomave duhet parë në fazën e tanishme të zhvillimit të gjuhës shqipe, kur sot folësi i zakonshëm shqiptar nuk e ndjen lidhjen e kuptimit të komponentëve me kuptimin e së tërës dhe si rjedhim ai i përdor idiomat në komunikim si njësi të vetme me një kuptim unik të formuar, pa menduar për kuptimin e gjymtyrëve të tyre. E theksojmë këtë se pamundësia e idiomave për t'u zbërthyer është produkt i zhvillimit të gjuhës. Idiomat nuk kanë qenë gjithënjë të pa zbërthyeshme. Kjo vihet re edhe në gjuhë të tjera¹⁾. Historikisht idiomat shqipe mund të motivohen, p.sh. *re* < lat. *grevis* = *gravis*²⁾, *pallë* < ngr. *παύλα* = pushim, qetësi³⁾, *dushk për gogla*, i *bie legenit*, — me burim episodik (shih për këtë Inst. i Shk. "Përralla popullore", V. I., fq. 37 në ark. e Inst. të Folklorit) etj. Bile dikur ato nuk kanë qenë kaq të ngurosurat sa sot, p.sh. "ajo me re e shikojti" (N. Frashëri, Istori e Skëndërbeut, Bukuresht 1898, f. 20), "me shumë re po shikonin" (po aty, 35); "heqim renë e këndonjësit mbi këtë libër të fundit..." (Ditërrëfjensë Kombiar, 1900, 21); "Duke e vështruar me re..." (po aty); "... Kina heq renë e botësë mbi vehten e saj" (po aty; 1901, 24) etj.

Nga ana tjetër ka edhe frazeologjizma në të cilët mund të duket ose të merret me mend lidhja nëmes kuptimit të komponentëve dhe kuptimit të së tërës, me që kuptimet e komponentëve marrin pjesë drejtpërdrejt në realizimin e kuptimit frazeologjik. Të motivuar nga kjo pikëpamje janë frazeologjizmat e formuar sipas tipareve të përmendur më lart e veçanë-

1) Shih edhe R.A. Budagov, vep. e cit., fq. 99.

2) Tek G. Meyer, *Etymologisches Wörterbuch der Albanesischen Sprache*, 1891, 362: *re* në *vë re* nga lat. *grevis* = *gravis* (it. *greve*, rum. *greu*); *vë re* "i jap rëndësi diçkaje" me *r* nga *gr* - si në *rëndë*.

3) Tek G. Meyer, 300: *pallë*[rri *pallë*] nga gr. *παύλα* (pushim, qetësi) prej *παύω* (pushoj së foluri, pushoj pas punës); shih edhe Kristof., 251.

risht sipas rastit të dytë. Ja dhe disa shembuj nga gjuha e folur: *luaj bishtin, nxjerr nga balta, le në baltë, sa çel e mbyll synë, bëj ballë, bëj durim* etj.

§ 6. — 3. *Shkalla e humbjes së pavarësisë dhe e ngurosjes së elementëve përbërës të frazeologjizmit*. Kuptimi i frazeologjizmit përcaktohet në tërësi, fjalët të çkëputura nga lidhja frazeologjike nuk ruajnë të njëjtin kuptim, p.sh. tek *bëj bisht* komponentët semantikisht e kanë humbur pavarësinë, kuptimi tërësor frazeologjik nuk del nga shuma e thjeshtë e kuptimeve të pavarura të elementëve përbërës, ata kushtëzojnë njëri-tjetrin dhe shkrihen në një të tërë. Po shpesh herë ndonjëri nga komponentët e frazeologjizmave fiksohet në një trajtë të caktuar dhe mbetet i pandryshuar, p.sh. *bëj këmbë, ja u mbath këmbëve, ze këmbën* e babait, i *bie këmbës, i vë këmbën (shqelmin), ndeu këmbët, tundi këmbën* (vdiq) etj., ku forma e emrit është e pandryshueshme (Fj. gj. shq. 1954, 210).

Me rolin që lot struktura formale në realizimin e frazeologjizmave do të merremi më gjerë në një vend tjetër.

II. PROBLEME TË STRUKTURËS SEMANTIKE

§ 7. — Frazelogjizmat e gjuhës, si ekuivalentë semantikë të fjalëve, mund të bashkëjetojnë me to në leksikun e shqipes, duke vendosur marrëdhënie sinonimie, për arsye se frazeologjizmat, ndryshe nga fjalët sinonime me ta, mund të shprehin nuanca të veçanta kuptimore, mund të kenë ngjyrë më të theksuar emocionale, mund të kenë më tepër karakter popullore (veçori të stilit gojor) etj. "Bile ekzistenca e dubleteve popullore rrjedh, qoftë nga fakti se ato mbajnë një metaforë, qoftë se shprehin një figurë, çfaqje të fantazisë, qoftë se kanë një përsëritje forconjëse, qoftë se përforcojnë një rast simbolizimi fonetik etj. ¹⁾". Pra, së pari, frazeologjizmat mund të kenë një kuptim më të gjerë se fjala sinonime ose një nuancë tjetër kuptimore, krh. shikoj dhe *hedh sytë* (=shikoj rastësisht), *vë re* (=shikoj gjatë dhe me një qëllim të caktuar, vërej), *ngul sytë* (shikoj i përqëndruar), *shtie sytë* etj. Së dyti, frazeologjizmat mund të shprehin një shkallë më të lartë a më të ulët të intensitetit të veprimit a të cilësisë, p. sh. *j m bërë derr* — jam mërzhitur shumë; më *hoqën veshin, më hoqën dru* (më *dhanë një dru* të mirë në mbledhje) — më kritikuan (në rastin i *heq dru* kritika është më e rëndë se sa tek *i heq veshin*); e *ngriti në qiell* (e lëvdoi shumë); "Po, antër nu, *hëngri një dajak* të mirë ahëre. Por tani punët sikur i "venë mbarë" (Q. Buxheli, vep. e cit., f. 27); e *mbaj në pëllëmbë të dorës* — shumë mirë (frazelogjizmi e shpreh cilësinë në shkallën më të lartë); duket si në *pëllëmbë të dorës-fare* qartë (gjithashtu) etj. Së treti, frazeologjizmat në shqipet mund të kenë një ngarkesë më të theksuar emocionale, ekspresiviteti, në krahasim me sinonimet e tyre njëfjalëshe, krh. nuk e *ndyjj dorën* me *tý* (vras, rrah), e *bënja mace* me *martinë* (vras), e *ngopi në dru* (e rahu), *s'i kalla djallin* etj. (s'çava kokën për të), *hëngri dhë* (vdiq), *fus hundët* (ndërhyj), e *la në baltë* (nuk i dha ndihmë, e gënjeu), *iku me bisht ndë shalë* (i turpëruar), i *ranë pëndët* etj. Së katërti, frazeologjizmat shprehin më tepër karakteristikat e gjuhës së folur popullore, p.sh. u kap *mpresh në dorë, ku t'i çon mushka drutë, mos ia krih bishtin, i ve fre gojës, e kam lakra në kopësht* (s'e kam asgjë), s'ja *var trastën* (nuk çaj kokën për të, s'e përfill), *shtyjj urët* (nxis), e *bëri për pesë para, e gjeti kokën e kandilit* etj.

1) T. Vianu: *Kërkimi i stilit*, dorëshkrim në ark. e Inst. Hist. Gjuh., 7.

Në këtë mënyrë frazeologjia lot një rol të madh diferencues në sistemin e leksikut dhe rol ekspresivo-emocional në sistemin e mjeteve shprehëse të gjuhës.

Prandaj identiteti i frazeologjizmit me fjalën nga domethënia duhet parë si relativ, në një raport sinonimie. Kur themi se frazeologjizmi është ekuivalent semantik i një fjale kemi parasysh vetëm funksionin e tyre emërtonjës, aftësinë për të shprehur një nocion të vetëm dhe jo përputhjen e plotë në përmbajtjen reale të tyre.

Jo rrallë frazeologjia plotëson mungesën e fjalëve të veçanta në shprehjen e disa nocioneve, p.sh. *heq dorë, bëj shaka, bëj qejf, hedh në erë* etj., që nuk kanë ekuivalentë njëfjalësh në gjuhën shqipe.

§ 8. — Tek frazeologjia e gjuhës vihen re po ato fenomene leksikologjike që janë karakteristike për leksikun në tërësi. Sikurse fjalët edhe disa frazeologjizma kanë aftësinë të marrin më tepër se një kuptim dhe ta zgjerojnë strukturën e tyre kuptimore, p.sh. *marr (merr) erë* 1) qelbet, 2) zbulohet (një punë), 3) di; *e preu gojën* 1) në agoni, 2) nuk ka të drejtë të kërkojë, 3) nga frika; *hyn në hesap* 1) ha në kurriz të një tjetri, 2) përzihet në çështje që s'i përkasin, 3) s'ka vlerë, s'ta mbush synë ("pra, dashuria nuk *hyn në hesap*", "Nëna e erërave", 108); *marr më qafë* 1) bëj të keq, dëmtoj, 2) të bën për vehte (të *merr më qafë* me bukurinë e saj); *bëj fjalë* 1) flas ("sot do të bëjmë fjalë për krijimet e Naimit"), 2) grindem ("pa pallton e grisur dhe bëri fjalë"); *marr vesh* 1) dëgjoj, 2) kuptoj; *hap sytë* 1) çuditem, 2) kam kujdes (hap sytë!), 3) arësimohem, edukohem etj.

Frazeologjizmat mund të vendosin marrëdhënie sinonimie edhe në mes tyre. Çiftet sinonimike të frazeologjizmave në shqipe krijohen midis shprehjesh krejtësisht të ndryshme ose edhe në mes shprehjesh të ndërtuara mbi bazën e një elementi të përbashkët, p.sh. *i ka lujtë terezia, s'i ka mend në krye, i ka lujtë çekerku, i ka lujtë mendja, i ka krisë mendja, i ka kalue mendja, i asht prishë terezia, i asht prishë mendja, i asht çartë mendja, i asht prishë terezia* 1), *ma ha mendja, ma kap mendja, ma pret mendja, ma merr mendja; flet kodra pas bregut, flet si e jëm'e Zeqos majë thanës, i bie legenit, rreh erë; rreh ujë në havanë, ban një birë n'ujë* etj. Duke qenë se mbështeten edhe në elemente të ndryshme, sinonimet frazeologjike kanë zakonisht nuanca të veçanta kuptimore — emocionale, po gjithnjë të afërta.

Antonimia në frazeologjizmat e gjuhës shqipe realizohet me tri rrugë: së pari, me anë shprehjesh të ndryshme, p.sh. *humbi mendjen — erdhi në vehte; i lëshoi pe — ja mblodhi rrypin; i bie mbrapa* (një punë) — *s'çaj kokën; e pagoi si frengu pulën — e bleu për një copë bukë, e do gjysëm pa haje* (lirë, Myz.) etj.; së dyti, me zëvendësimin e një komponenti të frazeologjizmit me antonimin e tij, p.sh. *i ka ikur mendja — i erdhi mendja; "punonjësit e Vlorës ka dy vjet që mbanin flamurin në dorë / po këtë radhë e lëshuan flamurin nga dora"* (Z. i Popullit), etj.; së treti, me pjesëzat mohonjëse, *nuk, s', pa, mos*, p.sh. *ma ha mendja — s'ma ha mendja; i jap udhë* (punës) — *nuk i jap udhë; duke marrë parasysh — pa marrë parasysh; merr me të mirë — mos e merr me të mirë* etj. Me këtë mënyrë e formojnë antonimin e tyre ata frazeologjizma të shqipes, në strukturën e të cilëve, pa i çpërbërë ata, mund të hyjnë edhe pjesëzat mohonjëse.

§ 9. — Në etapën e sotme të zhvillimit të gjuhës ndryshimi i kuptimit të frazeologjizmave të shqipes shkaktohet nga disa arsye.

Së pari, mund të ndryshojë kuptimi i tyre me ndryshimin e ndonjerit prej komponentëve përbërës, p.sh. *vari buzët* (u zemërua), *përdrodi buzët*,

1) Fjalorth frazeologjik anonim, dorëshkrim pranë sektorit të leksikologjisë,

shtrëmbëroi buzët (nuk u kënaq), *mblodhi buzët* (u tall); *bëj fjalë*, *bëj gati*, *bëj qejf*, *bëj shir*, *i bëj gropën* etj. Megjithëkëtë, ka raste kur edhe pse ndryshon njëri komponent, kuptimi frazeologjik nuk ndryshon kurrë bile as lloji i lidhjes sintaktike), p.sh. *ma ha mendja*, *ma kap mendja*, *ma pret mendja*, *ma merr mendja*; *shtie sytë*, *hedh sytë*; *s'më bën zemra*, *s'më bëjnë këmbët*; më *bëjnë veshët*, më *bëjnë sytë* (më duket) etj. Ndonjë ndryshim fare i vogël në kuptim këtu nuk i zgjidh këto shprehje nga marrëdhëniet sinonimike.

Së dyti, ndryshon kuptimi i frazeologjizmit kur në të hyjnë elemente të tjera, p.sh. *bëj vrimë* (brimoj) dhe *bëj vrimë n'ujë* (bëj punë pa fryt), *ve mend dhe ve ë mend*, *marr dorë dhe marr nën dorë*, *i bie këmbës dhe i bie së mirës me këmbë* etj.

Së treti, ndryshon kuptimi i frazeologjizmit kur njëri komponent ndryshon kategorinë gramatikore (trajtën, numurin, rasën etj.), p.sh. *hap synë* dhe *hap sytë*, *marr me mend* dhe *ma merr mendja* etj.

§ 10. — Duke i parë në plan të përgjithshëm semantik dhe në bazë të korelacionit të kuptimit frazeologjik me kuptimin e drejtpërdrejtë të togfjalëshit, në gjuhën shqipe dallohen frazeologjizmat me një kuptim të mundshëm nga ata me dy a më shumë kuptime të mundshme. Togfjalëshat e qëndrueshëm, të formuar historikisht dhe ekuivalentë me fjalë të vetme, që kanë vetëm një kuptim të mundshëm, janë gjithnjë frazeologjikë, p.sh. "*m'u bë gjaku ujë*" (nga frika), "*ha ana*" (anon), "*s'i binja në sy nga frika*", "*dhe të vegjëlve u trembet gjaku*", "*ai bar erdhi prak për këtë plagë*", (Skrapar). "*ka punuar dimri sivjet*"¹⁾ (ka rënë shi), *shes mend*, *bëj ballë* etj. Ekzistojnë konstruktet të tilla nga që të paktën njëri nga komponentët hyn në bashkëlidhje jo me kuptimin e drejtpërdrejtë, po me një nga kuptimet e tij derivate.

Togfjalëshat me dy a më shumë kuptime të mundshme mund të jenë, sipas kontekstit ku përdoren, të lirë ose frazeologjikë. Kuptimet e mundshme mund të jenë njëri i drejtpërdrejtë e tjetri (të tjerët) frazeologjik, p.sh. "*ikën e s'u a pamë më bojën*", "*plak jam e më ka rrjedhur truri*". "*nuk la gurë më këmbë që ta kandisë*", "*kur i thash ai hapi sytë*" (nga çudia, nga tmerr), "*ai e lëshoi brezin i pari*", "*i ranë pëndët*" etj. Të tillë frazeologjizma janë produkt i leksikalizimit të togfjalëshave të lirë.

§ 11. — Në disa frazeologjizma të shqipes ndodh të bashkëjetojë edhe kuptimi i mundshëm fillestar (i drejtpërdrejtë) i togfjalëshit edhe kuptimi frazeologjik, bile në të njëjtin kontekst. Do të mjaftonin për të ilustruar këtë fakt disa shembuj nga Çajupi: "*e kërkova dhe e gjeta*," *J tha uju me bisht ndër shalë*," (Mëmëdheu, 147); (lepuri) "*nga frik'e shkretë numuron çapët, J fle me s hapët, J me vesh përprjetë*"; "*Po shejtani na e pru J dhe na gjeti gju për gju!! . . .*" (Vepra, 23,); "*u' për vete të rroj mirë*", *J më tha dhe më ktheu kratë*" (107) etj. Mirëpo realizimi i kuptimit të drejtpërdrejtë të togfjalëshit herë është i domosdoshëm dhe herë jo për realizimin e kuptimit frazeologjik. Më të shumta janë rastet kur realizimi i kuptimit të drejtpërdrejtë të togfjalëshit nuk është i domosdoshëm për realizimin e kuptimit frazeologjik të atij togfjalëshi, p.sh. ". . . e ti vëliz zemërenë teme përhapëtë ñ duorshit s'atyne qi për të keq ecnjënë." (Buz. XIX 22 a); ". . . o gojëtareja tonë, ata sytë e tu të përmishëri-shim prej nesh kthe." (Buz. XVI 15b); "*Mos e kthe fagenë tande n meje, përse u të jem mbë shembëlltyrë t atyne që venë ndë liqët.*" (Buz. XVIII 19a). "*M tÿ ndena duortë e mÿ*;" (Buz. XVII 18 b); "*Edhe Greqija na*

1) Kartoteka e leksikut të shqipes.

nxjerr gjuhën e na xbardh dhëmbët prapa Pindosë. .” (Kalendari Kombiar, 1902, 162); **Mos hap dhëmbët*, — vazhdoi Dinshumi . . .” (N. Nosov, Aventurat e Dinpakut, 1957, 45, përkth. B. Dedja); “. . . përpigjet të verë botën nën thundër,” (Sh. Musaraj, vep. e cit., 1); “. . . ish rrugë, së cilës, shpejt a vonë, do i dilte kallai . . .” (po aty, 31); “. . . me ato shprehje plot qyfyre, që bënin të qeshje, po dhe t’i vërje gishtin kokës, . . .” (po aty); “Nuk e dini ju që edhe kalamajt e rrugëve të japin ujë në shoshë tani?” (po aty); “. . . një argument që i mbyll gojën edhe zotit Meçe.” (po aty, 9); “. . . janë mësuar t’i lëpijnë këmbët e të huajit.” (po aty, 48); “i vogël me trup po nga të bamet burrë me zemër” (pop.) etj. Tek frazeologjizmi, p.sh. “*mbyll gojën*”, sikurse edhe tek të tjerët, nuk është i domosdoshëm realizimi i kuptimit të drejtpërdrejtë të togfjalëshit për realizimin e kuptimit frazeologjik nuk flas, meqenëse që të mos flasësh nuk është e domosdoshme të mbyllësh gojën vërtetë (mund të mos flasësh edhe pa e mbyllur gojën konkretisht). Tek rasti “*burrë me zemër*” (trim), — fakti që shpreh elementi i dytë është i domosdoshëm fizikisht, kurse fakti që shprehet neutralisht nga komponenti i parë jo, siç shihet edhe në shembullin e dhënë; tek ky frazeologjizëm komponenti i parë ka hyrë në një nga kuptimet e tij derivate, por për realizimin e kuptimit frazeologjik, i gjithë togu burrë me zemër pëson një transformim figurativ.

Rasti i dytë, kur realizimi i kuptimit të drejtpërdrejtë të togfjalëshit është i domosdoshëm për realizimin e kuptimit frazeologjik të po atij togfjalëshi, nuk është shumë i zakonshëm në gjuhën shqipe. Ja disa shembuj: “O Autore, kujtoui në shëlbujmë sinë, që në motit të shkuom formë more në korp uman, . . .” (Buz. X 3b); “. . . more formë . . .” (id. 4b); “. . . kryenin nën urdhërat e tij një shërbim të madh duke u kthyer kudo pushkën partizane.” (Sh. Musaraj, vep. e cit., 30); “. . . ajo me një krah i bënte hije dhe me një i bënte erë.” (Inst. i Shk., “Përralla popullore”, vëll. I, pj. II, f. 13, Kurvelesh, Mbl. K. Harito); “— Ti mor bir nuk je imi, ik dhe ti pas letrës. J Mer dhe djali kokën e tija dhe hikën.” (po aty, f. 187, Gjrokastër); “ata që patën kokë përfituan.” (pop); “. . . pa hapur mirë gojën vajza (pa filluar të flasë, ai . . . e shikonte shtrembër . . .” (Sh. Musaraj, vep. e cit., 6); “. . . populli ynë është ngritur i tiri më këmbë . . . me yllin e kuq për simbol të lirisë, . . .” (po aty, 1); “a t’është ngritur në këmbë fëmija?” (=a ka filluar të eci?) etj. Si dhe në shembujt e mësipërm, tek shembulli i fundit “është ngritur në këmbë fëmija?” (ecën), fakti i shprehur neutralisht nga komponentët është i domosdoshëm për realizimin e kuptimit frazeologjik, sepse për të ecur është e domosdoshme të ngrihet në këmbë më parë, por megjithatë “është ngritur në këmbë” nuk do të thotë ecën në kuptimin e drejtpërdrejtë të togfjalëshit të lirë; kurse në rastin i *dha armët* (u dorëzua), fakti i shprehur neutralisht nga togfjalëshi i lirë herë është bazë për realizimin e kuptimit frazeologjik (p.sh. një ushtri që mundet, jep armët), por herë të tjera ai nuk është i domosdoshëm si fakt real (p.sh. u hangrën me fjalë po njëri s’ja doli dot dhe i *dha armët*). Kështu, kuptimi i drejtpërdrejtë i togfjalëshit disa herë përbën bazën për realizimin e kuptimit frazeologjik, i cili del si pasojë e tij e domosdoshme dhe bashkëjeton me të në të njëjtin togfjalësh.

§ 12. — Si semantemë për realizimin e kuptimit frazeologjik të një togfjalëshi në shqiptet mund të shërbejë kuptimi i drejtpërdrejtë i këtij togfjalëshi, i cili transformohet figurativisht mbi bazën e analogjisë për raste të ngjashme me rastin që shpreh modeli fillestar, mbi bazën e asociacionit të ideve, të paralelizimit të vetive, veprimeve, fenomeneve etj. Kjo është karakteristikë sidomos për frazeologjizmat që kanë lindur drejt-

përdrejt nga togfjalëshat e lirë, si p.sh. mos i *krih bishtin*, e *hodhi lumën*, i *fërkoj krahët*, *heq dorë*, i *naxjerr brylin*, "s'ja kemi thyer poganikun kësaj bime" (Skrapar, s'i kemi vënë emër) etj.

Por në shqipet ndodh që në semantemën e kuptimit frazeologjik të përmbahet procesi fillestar ose ai i fundit, proces që shprehet nga togfjalëshi i marrë si bashkim i lirë fjalësh. Si të thuash, i njëjti togfjalësh që shpreh frazeologjikisht një proces të caktuar, si togfjalësh i lirë shpreh ose procesin fillestar ose atë përfundimtar (rezultatit) që lidhet me kuptimin frazeologjik.

Tek shembulli "Do të bëj dhe unë një shtëpi si jotja, — tha dhe i *lëshoi spangon* shtëpisë sime" (Skrapar), togfjalëshi *lëshoj spangon* me kuptim frazeologjik *mas* shpreh si togfjalësh i lirë momentin fillestar për realizimin e procesit të matjes (kuptimi frazeologjik). Por pikërisht ky proces fillestar përbën temën semantike të togfjalëshit frazeologjik *lëshoj spangon*. Semantemë të tillë kanë togfjalëshat frazeologjikë dhe në shembujt që vijojnë: "s'ka *vënë brisk* akoma djali" (= nuk mund të qubet akoma i rritur; (Përmet); "shqiptari i *kthen gjoksin* armikut" (= e kundërshton, lufton me trimëri me të; Skrapar); "ahere e *zgjeshëm dhe ne pallën*" (=luftuam; Skrapar); "Shqipërin'e mori Turku, i *vu zjarr!*" (= djeg, shkrettoj; Çajupi, Mëmëdheu, 16); "nëqoftëse hesht *naxirra shpirtin*, sa të flasë." (=torturoje; edhe *asgjësoj*; Q. Buxheli; vep. e cit., 30) etj.

Kurse tek shembujt: "tashti që m'u rritën djemtë unë *festen mbi sy e hedh*" (Skrapar); "ta shanje atë të *bënte gropën*" (Myzeqe); "po kjo është për të *varrë vehten*" (= e tmershme; Myzeqe); "Do t'u bie me kobure, *J t'i lëshoj në shesh shondure*" (Çajupi, Vepra, 8); "Vjehrr'i ti s'punoi mbarë *J kur bëri dhëndër gomarë, J vetiut i bëri varrë*". (po aty, 8); "Pashë gruan me jaranë! *J Po tani do t'u bëj varrë!* / *Do t'u bie me kobure,*" (po aty); "Frika thonë njerst'e parë; *J dalngadalë na bën varë*" (po aty, 235); "U bëra *topil* = u laga shumë, u qulla nga shiu" (Shkolla Kombëtare I/1939, nr. 22, 19) etj., — procesi që shprehet nga togfjalëshat e nënvizuar të marrë si togfjalësha të lirë përbën pasojën a procesin e fundit, të mëpas-tajmë, mbi bazën e të cilit është ndërtuar kuptimi frazeologjik i këtyre togfjalëshave.

Probleme të tjera lidhur me strukturën semantike të frazeologjizmave të gjuhës shqipe lindin sidomos në studimin e bashkëveprimit semantik të komponentëve të frazeologjizmit; disa nga këto probleme do të ceken krahas problemeve të strukturës formale dhe të klasifikimit të frazeologjizmave të gjuhës shqipe.